Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission

RAPORTI MBI AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË PËR VITIN 2019

01 janar – 31 dhjetor 2019

Mars, 2020
Prishtinë

P Ë R M B A J T J A

1. Përmbledhje ekzekutive
2. Korniza ligjore
3. Përshkrimi i Institucionit (Organizmi institucional)
4. Fushëveprimi që e mbulon institucioni
5. Aktiviteti për periudhën raportuese
6. Pjesa e fundit e raportit - rekomandimet/sfidat e institucionit (rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)
7. Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm
8. Raporti financiar

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Duke u bazuar në Nenin 87.2.13 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji dhe të legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të Marsit të vitit vijues kalendarik.

Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në Kosovë, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2019.

Përgatitja e këtij raporti përmbush edhe kërkesën e Nenit 87.2.12 të Ligjit për Prokurim Publik, sipas të cilit KRPP-ja duhet t'i grumbullojë, t'i analizojë dhe t'i publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat e dhëna publike.

Është ky viti i katërmbëdhjetë me radhë që KRPP-ja përgatitë një raport të tillë, duke u munduar që për çdo vit ta avancojë dhe ta kompletojë atë sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ta kenë një pasqyrë të plotë mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2019

Ky raport do të jetë mjaft i mirëseardhur edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse do të kenë në dispozicion një raport në të cilin përfshihen aktivitet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteteve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit.

2. KORNIZA LIGJORE

2.1 Baza ekzistuese ligjore që e rregullon Agjencinë

Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) është themeluar në bazë të Pjesës VI të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
Sipas nenit 86 të këtij ligji, KRPP-ja është agjenci e pavarur rregullative dhe sipas nenit 87 të këtij ligji është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.
Me qëllim të funksionimit të mirë, KRPP ka nxjerrë Rregulloren e Punës, e cila ofron një sërë udhëzime operative praktike për menaxhmentin dhe stafin e KRPP-së.
Rregullorja e punës së Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik, është publikuar në ueb-faqen e KRPP-së https://e-prokurimi.rks-gov.net

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT (ORGANIZIMI INSTITUCIONAL)

3.1 Misioni/Vizioni

Misioni i KRPP-së është zhvillimi funksionimi dhe mbikqyrja e përgjithshme e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e sistemit elektronik të prokurimit publik në Kosovë (E-Prokurimi).

Si rrjedhojë, misioni i KRPP-së është të nxis respektimin e parimeve themelore të prokurimit lidhur me transparencën, llogaridhënien, konkurrencën e ndershme, trajtim të barabartë dhe vlerën për para duke përmirësuar kapacitetin e sistemit të prokurimit përmes:

- Avancimit të sistemit të monitorimit për zbatimin të kornizës ligjore të prokurimit publik;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, trajnimi dhe arsimi;
- Avancimi i procedurave të menaxhimit të prokurimit publik;
- Rrjedhë më të mirë të komunikimit në mes të të gjithë akterëve të prokurimit publik;
- Prezantimin e objektivave socio-ekonomike dhe mjedisore, në kuadër të politikave të gjelbra dhe të përgjegjshme shoqërore të prokurimit publik;
- Shfrytëzimin e metodave të reja bashkëkohore në zbatimin e ligjit të prokurimit publik si: prokurimit elektronik dhe prokurimi i centralizuar; si dhe
- Ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për funksionimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

3.2 Funksionet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik sipas ligjit

Funksionet kryesore të KRPP-së janë të detajuara në Nenin 87 të Ligjit dhe mund të përmblidhen si më poshtë:

- FUNKSIONI LIGJOR
- FUNKSIONI I MONITORIMIT
- FUNKSIONI I TRAJNIMIT dhe
- FUNKSIONI I REVOKIMIT TË CERTIFIKATAVE TË PROKURIMIT

Funksioni Ligjor

Departamenti i Rregullave të KRPP-së është përgjegjëse për vendosjen e rregullave dhe kushteve që rregullojnë implementimin e çdo llojit të aktiviteteve të prokurimit publik në Republikën e Kosovës, përfshirë kontratat kornizë. Për më shumë, KRPP është përgjegjëse që të nxjerrë dhe të shpallë masa të hollësishme zbatuese. Masat zbatuese përbëhen nga rregulla, udhëzime, dokumente dhe formular standard të tenderit dhe të kontratës. Të nxjerrë rregulla për autoritetet kontraktuese në lidhje me përdorimin e procedurave të prokurimit elektronik në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe rregulla për menaxhimin e kontratave. Ngjarje iniciuese për intervenime të KRPP-së në Legjislacionin sekondar të Prokurimit Publik do të jenë zbrazëtira dhe mangësi që përsëritën të detektuara dhe dokumentuara gjatë monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik.

Funksioni i monitorimit

Departamenti i monitorimit kryen monitorimin e planifikuar, monitorimin sipas rastit (ad-hoc) të prokurimit dhe monitorimin e Njoftimeve.

Funksioni i Trajnimeve

Departamenti i Trajnimeve të KRPP-së është përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e moduleve trajnuese dhe kurrikulës për kualifikimin e zyrtarëve të prokurimit. Në këtë aspekt Departamenti i Trajnimeve do të shfrytëzojë zbrazëtirat dhe mangësitë e detektuara dhe dokumentet gjatë monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik. Departamenti i Trajnimeve është gjithashtu përgjegjës për të identifikuar trajnerë të përshtatshëm (trajner individë apo organizata të trajnimeve) në prokurimin publik për të ofruar kurset relevante. Departamenti, në bashkëpunim me IKAP-in, duhet të aranzhojnë zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë për trajnime bazike dhe dhjetë ditë (10) për trajnime të avancuara dhe do të jetë përgjegjës për organizimin e provimeve. Trajnerët duhet të kenë përvojë në trajnime të prokurimit publik, në praktikat më të mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së.

Funksioni i Revokimit të Certifikatës

Revokimi i një certifikate profesionale të prokurimit mund të inicohet nga:

a. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
b. Organi Shqyrtues i Prokurimit; ose
c. Çdo autoritet kontraktues

Kërkesa për revokim të certifikatës duhet te dorëzohet në KRPP dhe duhet të dokumentohet në mënyrë të rregullt. Pas pranimit të kërkesës, KRPP-ja themelon një komision për të shqyrtuar rastin dhe dorëzon kërkesën e tillë dhe dokumentacionin përkatës tek komisioni. Komisioni shqyrton rastin dhe ka të drejtë të kërkojë informacion, sqarime dhe/ose dokumentacion të mëtejshëm nga autoriteti që ka paraqitur kërkesën, në rast se dokumentacioni i paraqitur konsiderohet i pakompletuar apo jo i kënaqshëm. Pas shqyrtimit, komisioni jep mendimin e vet të dokumentuar te Bordi i KRPP-së. Bordi mund të kthej mendimin e paraqitur tek komisioni në rast se dokumentacioni konsiderohet i pakompletuar apo jo i kënaqshëm. Bordi i KRPP vendos në bazë të kërkesave të përcaktuara në nenin 23 të LPP-së. Në rast se kërkesat e përmendura nuk janë plotësuar, KRPP-ja do të revokojë certifikatën në përputhje me procedurat e përmendura në paragrafin 8 të nenit 25 të LPP-së. Vendimi i Bordit të KRPP-së i komunikohet organit që ka paraqitur kërkesën e revokimit dhe Zyrtarit përkatës të Prokurimit. Nëse mbajtësi i certifikatës nuk është nëpunës civil, personi në fjalë gëzon të drejtën që të njoftohet paraprakisht me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj. Nëse personi është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankohet për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative. Nëse mbajtësi i certifikatës është nëpunës civil, autoriteti përkatës do të fillojë procedurat e nevojshme në bazë të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Zyrtari i prokurimit të cilit i është revokuar certifikata mund të fillojë trajnimin bazik të prokurimit publik, pas një periudhe njëvjeçare nga revokimi.

KRPP në strukturën e saj organizative ka gjithsej pesë divizione, katër prej të cilave i kryejnë funksionet në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me nenet 25, 81, 87 dhe 88 këtë ligj, si në vijim:

DEPARTAMENTI I RREGULLAVE

Në bazë të nenit 87 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Departamenti i Rregullave kryen funksionet si në vijim:

- Vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të LPP-së nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilës nga procedurat e përcaktuara në nenet 33-37 të LPP-së; me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara nga LPP si dhe çfarëdo kërkese të detyrueshme të BE-së për prokurim;
- Përgatitë dhe shpërndan doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas LPP-së në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- Ofron ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të LPP-së si dhe për çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- Nxjerrë dhe publikon interpretime me shkrim të vendimeve administrative për të dyjat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;
- Zhvillon rregullat e detajuara në lidhje me shitjen e aseteve të Autoriteteve Kontraktuese;
- Studion Raportet e monitorimit dhe rekomandimet tjera dhe bashkëpunon ngushtë me Departamentin e Monitorimit, për përmirësimin e rregullave të sistemit të prokurimit publik dhe/ose të ligjit;
- Nxjerrë, pas bashkëpunimit të ngushtë me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, rregulla në lidhje me e-prokurimin, dhe më konkretisht transmisionin elektronik të dokumenteve të tenderit dhe kërkesave për pjesëmarrje dhe pranimin e propozimeve. Këto rregulla duhet të përfshijnë një nënshkrim të avancuar elektronik, në pajtim me standardet ndërkombëtare;

Përveç funksioneve të autorizuara me ligj, Departamenti i Rregullave kryen edhe këto funksione shtesë:

- Mbështetë punën e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik, duke kryer analiza ligjore gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit dhe legjislacionit dytësor nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik;
- Mbikëqyrë pranimin e kërkesave dhe dokumenteve të bashkangjitura të parashtruara nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik, vlerëson nëse nevojitet kompletim apo sqarim dhe shqyrton opinionin e mundshëm ligjor në bashkërendim me kryetarin dhe anëtarin e bordit përgjegjës për divizion;
- Cakton dhe mban takime për konsulta, ndihmë teknike dhe këshilla sipas kërkesës së autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik në bashkërendim me kryetarin dhe anëtarin e bordit përgjegjës për divizion;
- Harton opinione, interpretime ligjore dhe këshilla lidhur me rastin që është objekt i kërkesës për interpretim ligjor;

- Siguron shpërndarjen e përgjigjes me shkrim përmes arkivit të KRPP-së pasi që e njëjta të jetë nënshkruar nga eksperti i prokurimit (hartuesi), anëtari i bordit përgjegjës për divizion dhe kryetari i KRPP-së; siguron shpërndarjen e përgjigjes përmes postës elektronike, si dhe në bashkërendim me anëtarin e bordit përgjegjës për divizion dhe kryetarin siguron publikimin në ueb-faqen e KRPP-së nëse për të njëjtën konsiderohet si pyetje e shpeshtë apo si një zgjidhje e problemit të mundshëm të ballafaqimit edhe të autoriteteve tjera kontraktuese;
- Mban takime për: a) Bashkërendim të punëve të Departamentit; b) Diskutim të çështjeve ligjore me kryetarin dhe anëtarin e bordit përgjegjës për divizion lidhur me kërkesat për interpretim të parashtruara nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik përmes arkivit të KRPP-së dhe postës elektronike në E-MAIL-in zyrtar info.krpp@rks-gov.net; c) Konsulta me Bordin e KRPP-së, Udhëheqësit e Departamentit të Monitorimit dhe të Departamentit të TI-së lidhur me funksionimin efektiv dhe efikas të KRPP-së për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT:

Në bazë të nenit 88 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Departamenti i Monitorimit kryen funksionet si në vijm:

a. sipas planit;
b. sipas rastit; dhe
c. duke i përcjellur njoftimet.

a) <u>Monitorimi i planifikuar i prokurimit</u>

- Përgatit çdo vit një plan të punës për monitorimin e aktiviteteve të prokurimit të identifikuara për monitorim ex-post dhe të menaxhimit të kontratës të autoriteteve kontraktuese të përzgjedhura dhe të njëjtin e dorëzon tek Bordi për miratim;
- Monitoron aktivitetet e kryera të prokurimit dhe menaxhimit e kontratave aktiviteteve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese me qëllim të verifikimit nëse është zbatuar në mënyrë të drejtë LPP, dhe aktet nënligjore, nga inicimi i një aktiviteti të prokurimit deri në realizimin e plotë të kontratës, në përputhje me planin vjetor të punës;
- Në raste të konstatimit të shkeljeve të ligjit nga ana e autoritetit kontraktues, organizon një takim, me pjesëmarrje të personave përgjegjës për të diskutuar rastin, shpjegojë, sqarojë dhe të elaborojë masa të cilat do të ndërmerren;
- Dërgon raportet e monitorimeve të planifikuara, te: i. Zyrtari përgjegjës i prokurimit të autoritetit kontraktues përkatës; ii. te organi përkatës për mbikëqyrje (Kryetari i komunës në raste të komunave, Ministri dhe Sekretari Permanent në raste të ministrive përkatëse, Drejtorët/Udhëheqësit më të lartë të ndërmarrjeve publike etj.); dhe iii. në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit në mënyrë që të publikohen në ueb-faqe të internetit të KRPP-së.

b) Monitorimi i prokurimeve sipas rastit

- Kryen monitorim sipas rastit të një aktiviteti të prokurimit në implementim e sipër dhe i përfunduar, përfshirë këtu edhe kohën gjatë realizimit të kontratës, në autoritetet kontraktuese të zgjedhura, bazuar në informacionin e pranuar nga autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomik apo palët e treta të pranuara nga KRPP;
- Monitoron ekzistencën dhe kompletimin e dosjes së tenderit para publikimit të njoftimit të kontratës (Kjo dispozitë nuk aplikohet në rast të shfrytëzimit të platformës elektronike);
- Nxjerrë këshilla profesionale në rastet kur konstaton se një aktivitet i prokurimit i autoritetit kontraktues nuk është në përputhje me LPP-në dhe legjislacionin dytësor dhe në veçanti në rastet kur autoriteti kontraktues nuk ka dokumentuar vendimin(et);
- Në raste të konstatimit të shkeljeve të ligjit nga ana e autoritetit kontraktues, organizon një takim, me pjesëmarrje të personave përgjegjës për të diskutuar rastin, shpjegojë, sqarojë dhe të elaborojë masa të cilat do të ndërmerren. Raportet e monitorimeve sipas rastit i dërgon te: i. Zyrtari përgjegjës i prokurimit të autoritetit kontraktues përkatës, ii. Operatori ekonomik, në rast se aplikohet; iii. Te organi përkatës për mbikëqyrje (Kryetari i komunës në raste të komunave, Ministri dhe Sekretari Permanent në raste të ministrive përkatëse, Drejtorët/Udhëheqësit më të lartë të ndërmarrjeve publike etj.); dhe iv. në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit në mënyrë që të publikohen në ueb-faqe të KRPP-së.

c) Monitorimi duke i përcjellur njoftimet

- Autoritetet kontraktues njoftojnë KRPP, për rastet në vijim: a) autoriteti kontraktues ka vendosur të përdorë procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë (sipas Nenit 35, paragrafi 1 të LPP-së), b) autoriteti kontraktues ka vendosur të anulojë procedurën e prokurimit për arsye të çmimit abnormalisht të ulët (sipas Nenit 61, paragrafi 5 të LPP-së).
- Monitorojë cilindo nga rastet e përmendura më lart (neni 9.4.3.1), pas vendimit të Udhëheqësit të Departamentit të Monitorimit, duke i ftuar, kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese në fjalë për të rishikuar vendimet e tyre. KRPP-ja duhet të bëjë ketë brenda dy (2) ditë pas marrjes së këtij njoftimi. Sipas nenit 9.4.3.3, nxjerr këshilla profesionale për autoritetin kontraktues, kur KRPP, konstaton se një aktivitet i tillë i autoritetit kontraktues nuk është në përputhje me LPP dhe legjislacionit dytësor dhe në veçanti në rastin kur autoriteti kontraktues nuk e ka arsyetuar (dokumentuar), plotësisht vendimin(et) e tij. Opinionet e KRPP-së të lëshuara në përputhje me paragrafin 9.4.3.1 (a), kanë karakter jodetyrues për autoritetet kontraktuese, por autoritetet kompetente mund t'i marrin ato në konsideratë gjatë trajtimit të ankesave të paraqitura në përputhje me Pjesën IX të këtij ligji.
- Te gjitha njoftimet, sipas mostrave, të dorëzuara në KRPP nga autoritetet kontraktuese kontrollohen gjatë periudhës 2-ditore para publikimit. Gjatë kësaj periudhe Departamenti i Monitorimit nxjerrë rekomandime me shkrim drejtuar Autoritetit kontraktues për korrigjimin e gabimeve ose mangësive. Autoriteti kontraktues do të publikojë dhe qarkullojë korrigjimet;
- Të gjitha njoftimet e dorëzuara ne KRPP përmes sistemit të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese mund të kontrollohen gjatë periudhës së publikimit deri në hapje. Gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Monitorimit mund të nxjerrë rekomandime me shkrim

drejtuar Autoritetit kontraktues për korrigjimin e gabimeve ose mangësive. Autoriteti kontraktues ka përgjegjësi të plotë për të vendosur se si të merr parasysh këto rekomandime;

- Zhvillon dhe miraton metodologjinë e nevojshme dhe manualin për monitorimin e pajtueshmërisë dhe matjen e performancës së Sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë dhe përcakton treguesit relevant sasior dhe cilësor për të matur performancën dhe pajtueshmërinë me ligjin të autoriteteve kontraktuese dhe stafit të prokurimit, si dhe për të vlerësuar në tërësi sistemin kombëtar të prokurimit publik;
- Zbaton metodologjinë e mësipërme dhe manualin duke zhvilluar një plan të punës; duke vazhduar me mbledhjen e të dhënave në terren përmes pyetësorëve ose metodave të tjera; vendosjen e të dhënave në një bazë të dhënave për analiza; vlerësimin e vlerave të indikatorëve ose informacione të tjera relevante cilësore; raportimin e të gjitha gjetjeve tek Bordi i KRPP-së në baza të rregullta dhe integrimin e tyre në raportet e KRPP-së; mbështetja e çdo veprimi që rrjedh nga gjetjet e performancës dhe të pajtueshmërisë;
- Përgatitë dhe elaboron raportet vjetore të pajtueshmërisë dhe performancës që identifikojnë përparësitë dhe mangësitë në implementimin e Ligjit, në sistemin e prokurimit publik dhe implementimin e aktiviteteve të kontratave. Raportet do t'i paraqiten Bordit të KRPP-së për hapat e mëtejshëm në përgatitjen e një strategjie për të rritur performancën e zbatimit të sistemit të prokurimit publik, si dhe rekomandimet për përmirësim;
- Elaboron dhe dorëzon tek Departamenti i rregullave, Departamenti i trajnimeve dhe Integrimeve Evropiane çdo rekomandim për përmirësim në sistemin dhe/ose Ligjin e prokurimit publik, me theksim të veçantë në aktivitetet e prokurimit.

DEPARTAMENTI I TRAJNIMEVE DHE INTEGRIMEVE EUROPIANE

Në bazë të nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Departamenti i trajnimeve dhe Integrimeve Evropiane kryen funksionet si në vijim:

- Zhvillon module të trajnimit dhe kurrikulës për kualifikimet në prokurim për trajnimin Themelor dhe të Avansuar (Nivelin Qendror dhe Lokal, OE, OJQ) duke përgatitë katalogun, programet, modulet për trajnime, të cilat aprovohen nga Bordi i KRPP –së;
- Harton një listë të dokumentuar të kualifikimeve për certifikim si trajnerë dhe si pjesëmarrës në trajnimet e prokurimit. Lista e kualifikimeve publikohet në ueb-faqen e KRPP-së;
- Identifikon personat, me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset e prokurimit të hartuara nga KRPP-ja për Trajnim Themelor dhe të Avansuar;
- Siguron që trajnerët e përzgjedhur të jenë persona të certifikuar për trajnim dhe të jenë të trajnuar nga një institucion i trajnimeve që ka ekspertizë substanciale në praktikat më të mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së.
- Përzgjedh dhe Ripërtërin Listën e trajnerëve për çdo 5 vite nga Komisioni i Përcaktuar nga Kryetari i KRPP-së;
- Propozon angazhimin e trajnerëve nga Lista e trajnerëve për programe të trajnimit Themelor dhe të Avancuar për çdo vit në Bordin e KRPP-se;

- Në bashkëpunim me IKAP-in, aranzhon zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë për trajnime bazike dhe dhjetë ditë (10) për trajnime të avancuara sipas Memorandumit të Bashkëpunimit ne mes të KRPP- IKAP;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, është përgjegjëse për organizimin e provimeve në mbështetje të Rregullores për procedurat e zhvillimit të testeve në programet e trajnimit për Prokurim Publik;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, lëshon "certifikatën themelore profesionale të prokurimit" vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset themelore dhe të cilët rekomandohen nga Komisioni i vlerësimit të testeve;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, lëshon "certifikatën e avancuar profesionale të prokurimit" vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset e avancuara dhe të cilët rekomandohen nga Komisioni i vlerësimit të testeve;
- Përkrahë IKAP-in dhe autoritetet tjera publike për edukim dhe trajnim për të implementuar trajnime të nivelit të lartë për zyrtarët e prokurimit dhe profesionistëve të tjerë të prokurimit, që synojnë në implementimin e praktikave të mirëfillta të prokurimit dhe të respektimit të Ligjit;
- Është përgjegjës për elaborimin e moduleve të trajnimit mbi Prokurimin Publik dhe përtrirjen e tyre, sipas nevojave të trajnimit dhe ndryshimeve në Ligjin e Prokurimit Publik dhe legjislacionin dytësor;
- Zbaton analiza periodike të nevojave për trajnime për zyrtarët e prokurimit publik në Kosovë, operatorët ekonomik dhe për stafin e KRPP-së, në mënyrë që të definojnë nevojat e tyre për trajnime;
- Mirëmban dhe përtërinë databazat e Autoriteteve Kontraktuese (AK-të), zyrtarëve të certifikuar të prokurimit dhe trajnerëve të certifikuar në prokurim publik;
- Përforcon vetëdijen në mesin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat.

Përveç funksioneve të autorizuara me ligj, Departamenti i trajnimeve dhe Integrimeve Evropiane kryen edhe këto funksione shtesë:

- Ofron mbështetje për pjesëmarrjen e KRPP-së në aktivitetet e procesit të integrimit evropian dhe koordinon të gjitha aktivitetet e nevojshme të kërkuara nga KRPP-ja;
- Monitoron dhe raporton për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në lidhje me prokurimin publik në Kosovë. dhe harmonizimin e legjislacionit përkatës me acquis të BE-së;
- Bashkëpunon me MF dhe MIE rreth Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe raporton në baza tre mujore rreth këtij plani;
- Koordinon asistencën e IPA-së dhe ndihma të tjera të huaja për aktivitetet e KRPP-së dhe siguron që kanë të bëjnë me prioritetet e KRPP-së dhe sistemit të prokurimit publik të Kosovës;

DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Në bazë të nenit 87 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Departamenti i Teknologjisë Informative kryen funksionet si në vijim:

- Mirëmban dhe është përgjegjës për administrimin e platformës së prokurimit elektronik dhe të gjitha komponentët e nevojshme hardëare dhe softëare;
- Është përgjegjës për zbatimin e politikave, procedurave dhe rregulloreve për sigurinë e TI-së; administrimin e aplikacionit; administrimin e bazës së të dhënave; planifikimin e vazhdimësisë së biznesit; planin e menaxhimit/veprimit të rrezikut; planifikimi nga rimëkëmbja prej fatkeqësive; politika e kopjes rezervë (Back-up); politika arkivore;
- Mirëmban Regjistrin Elektronik të Prokurimit Publik, si pjesë të platformës së prokurimit elektronik, që do të shërbejë si arkiv për kopje elektronike të të gjitha njoftimeve, ftesave, deklaratave, dosjeve të tenderit, raporteve, ankesave dhe vendimeve të arkivuara apo të lëshuara në lidhje me secilin aktivitet të prokurimit të performuar apo të inicuar nga një autoritet kontraktues;
- Mbështet zhvillimin e sistemit elektronik për monitorimin e respektimit të LPP, nga autoritetet kontraktuese, përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që do të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese që i nënshtrohen ligjit;
- Mbështet zhvillimin e metodave elektronike të prokurimit, të tilla si e-prokurimi, ankandin elektronik dhe sistemin dinamik te blerjes, në përputhje me dispozitat e LPP-së;
- Mbështet prezantimin dhe përdorimin, nga të gjitha palët e përfshira, të nënshkrimit elektronik, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Përveç platformës se prokurimit elektronik, kryen edhe funksionet tjera:

- Ofron mbështetjen e nevojshme për sistemet tjera të TI të KRPP-së;
- Siguron funksionimin e sistemeve të TI të KRPP-së dhe për zhvillimin, integrimin, pajtueshmërinë dhe sigurinë e infrastrukturës së TI të KRPP;
- Mirëmban faqen e internetit të KRPP, duke i siguruar publikut qasje të pa kufizuar në: a) Ligj dhe tërë legjislacionin sekondar të lëshuar nën autoritetin e Ligjit, b) çdo interpretim dhe dokumente, c) të gjitha informacionet që përmbahen në Regjistrin e Prokurimit Publik d) të gjitha raportet e përgatitura nga Departamenti për Monitorim, si rezultat i procedurave të monitorimit.
- Siguron këshilla dhe udhëzime të detajuara për të gjithë stafin që përdorin sistemin e TI në lidhje me dispozitat e sigurisë së TI. Këto dispozita duhet të zbatohen nga i gjithë stafi i KRPP-së, që përdorin sistemin e TI;
- Mbështet zbatimin e Politikave dhe Procedurave të Sigurisë së KRPP-së. I gjithë personeli duhet të informohet në lidhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe Politikat dhe Procedurat e mësipërme, nga legjislacioni i ASHI-së, KRPP-së dhe institucionet tjera, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe duhet t'i zbatojnë ato;

- Sektori i tavolinës ndihmëse i përgjigjet kërkesave për ndihmë teknike me anë të telefonit, dhe në mënyrë elektronike të gjitha Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomik, dhe i këshillon mbi veprimin e duhur që të ndjekin procedurat standarde;
- Përcjell problemet që mund të shfaqen për të korrigjuar platformën dhe identifikon situata që kërkojnë vëmendje urgjente;
- Publikon njoftimet e pranuara nga Departamenti i Monitorimit, pasi që njoftimet të kenë kaluar procedurën e kontrollimit nga Departamenti i Monitorimit. (Kjo dispozitë nuk aplikohet për shfrytëzuesit e platformës elektronike).

4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI

KRPP-ja ka katërdhjetë e dy (42) pozita të aprovuara prej te cilave tridhjetë e shtate (37) janë shërbyes civil , tre (3) janë Funksionar Publik (Bordi i KRPP-se), ndërsa dy (2) janë ekspert te punësuar ne baze te ligjit te punës .
Numri aktual i te punësuarve ne KRPP është tridhjetët e tete (38) .

Katër (4) vende të punës janë ende të pa plotësuara.

Ne baze te LPP-se mandati i bordit të KRPP-se është pesë (5) vjeçar , anëtarët e bordit të KRPP-së janë emëruar me vendimin e datës 03.08.2015 dhe Kryetari me vendimin e datës 02.11.2018 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Organogrami i KRPP-se është bashkangjitur në këtë raport si ANEX I

Bordi i KRPP-së

Bordi i KRPP-së, është institucioni më i lartë për marrjen e vendimeve kolektive të KRPP-së. Kryetari gjithmonë është njëri nga anëtarët.Vetëm Bordi do t'i ketë të drejtat si në vijim:

- Të aprovojë aktet dytësore dhe çdo amendament tjetër;
- Të aprovojë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend raportin vjetor të punës, jo më vonë se në fund të muajit mars të vitit kalendarik të radhës, që analizon aktivitetet e prokurimit në Kosovë që ndodhin gjatë atij viti kalendarik dhe që bënë rekomandime për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose ligjit aktual;
- Të aprovojë strategjitë dhe planet tjera të KRPP-së;
- Të nxjerrë udhëzime për trajtimin e dokumenteve;

Bordi i KRPP-së është përgjegjës për të organizuar dhe menaxhuar punën e divizioneve përkatëse dhe për implementimin e funksioneve apo aktiviteteve tjera të përcaktuara nga Kryetari. Bordi i KRPP-së siguron mbështetjen teknike dhe administrative për funksionimin efektiv dhe efikas të Divizioneve. Anëtarët e Bordit të KRPP-së, janë emëruar sipas nenit 89 të LPP, dhe mund të largohen ose suspendohen vetëm sipas nenit 93 të LPP.

Funksionet e Kryetarit të KRPP-së

- Kryetari përfaqëson, menaxhon dhe organizon punën e KRPP-së dhe ka përgjegjësinë e përgjithshme për performancën e punëve ditore;
- Përgjegjësia për të kryer funksionet dhe aktivitetet e KRPP-së të cilat nuk janë përcaktuar apo përfshirë në ndonjë Divizion bie mbi Kryetarin;
- Kryetari ka autoritetin që të caktojë cilindo anëtar të stafit për të organizuar dhe menaxhuar punën e KRPP-së në fusha të caktuara, në veçanti funksione specifike apo aktivitete të cilat nuk janë të përfshira në funksionet apo aktivitetet e Devizionit të KRPP-së. Kryetari ka për të informuar anëtarët e Bordit për ndonjë përcaktim të tillë. Një kopje e dokumentit në lidhje me delegimin e përgjegjësive do t'i bartet Menaxherit të personelit, i cili do të kujdeset për dosjen dhe t'i përfshijë ato përgjegjësi të deleguara herë pas here. Kryetari mund t'i ndryshojë këto përgjegjësi ashtu siç ai/ ajo i sheh të arsyeshme;
- Kryetari do të thërret takimet e Bordit të KRPP-së, kur dhe si ai konsideron të jetë e nevojshme apo kur kërkohet nga dy anëtarët e tjerë të KRPP-së;
- Kryetari do të udhëheq takimet e Bordit të KRPP-së. Në raste të jashtëzakonshme kur është e nevojshme që KRPP, të ketë një takim në mungesë të Kryetarit, ai duhet të autorizojë një nga anëtarët tjerë të Bordit të KRPP-së për të udhëhequr takimin;
- Aprovon listën e vendeve të punës;
- Aprovon përshkrimin e vendeve të punës;
- Përcakton detyrat e nëpunësve të KRPP-së;

- Shkarkon nënpunësit;
- Ka përgjegjësi për menaxhimin e fondeve financiare të KRPP-së;
- Përcakton një anëtarë tjetër për të prezantuar, menaxhuar, dhe organizuar punën e KRPP në mungesë të Kryetarit p.sh të ushtrojë detyrën e Kryetarit. Ky person mund të ndryshojë prej një mungese në tjetrën;
- Jep udhëzime duke siguruar qarkullimin e dokumenteve brenda KRPP;
- Konkludon dhe nënshkruan marrëveshje dhe kontrata të nevojshme për të kryer funksionet e KRPP-së;
- Nënshkruan dokumentet në emër të KRPP-së, nënshkruan të gjitha vendimet e arritura nga Bordi. Asnjë dokument zyrtar nuk duhet të lëshohet nga KRPP, i cili nuk është nënshkruar nga Kryetari, përveç komunikimeve elektronike;
- Siguron se Rregullat e Procedurave Financiare të Ministrisë së Financave (MF) janë zbatuar nga secili punëtorë i KRPP-së, në fushat e tyre funksionale;
- Monitoron dhe kontrollon shpenzimet e KRPP-së;
- Siguron se të gjithë nënpunësit të cilët kanë përgjegjësi për administrimin financiar janë të këshilluar në mënyrën e duhur;
- Siguron se ekziston një ndarje e qartë e detyrave ne mes administrimit të financave dhe kontrollit adekuat.

Funksionet e anëtarit të Bordit

- Anëtari i Bordit merr përsipër përgjegjësinë e Departamentit nën përgjegjësinë e tij në të gjitha fushat e funksionimit te tij, duke përfshirë, ndër të tjera, çështjet organizative, punën dhe produktet e punës;
- Propozon përshkrimet e vendeve të punës për Udhëheqësin e Departamentit;
- Cakton detyrat për Udhëheqësin e Departamentit;
- Nënshkruan dokumentet e lëshuara nga Departamenti. Asnjë dokument zyrtar nuk duhet të lëshohet nga Departamenti, i cili nuk është nënshkruar nga anëtari i Bordit, përveç komunikimeve elektronike.

5. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2019

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik. Gjatë vitit 2019 në Kosovë janë evidentuar 161 autoritete kontraktuese që kanë kryer prokurime, ndërsa për 16 autoritete kontraktuese prokurimet i ka kryer Agjencioni Qendror i Prokurimit.

Përmes raporteve vjetore mbi kontratat e nënshkruara publike, të cilat autoritetet kontraktuese gjatë janarit të vitit 2020, i kanë dërguar në mënyrë elektronike pranë Departamentit të monitorimit, ky divizion pra i ka pranuar dhe ka kontrolluar këto raporte të dërguara nga autoritetet kontraktuese.

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese, shihet se gjatë vitit 2019 në tërë Kosovën janë nënshkruar 12461 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, duke i përfshirë të gjitha llojet e vlerave të kontratave.

Në vazhdim të raportit do t'i paraqesim prokurimet publike në Kosovë sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019. Duke pasur për bazë raportet e viteve paraprake, të përgatitura nga KRPP-ja sipas kërkesave të LPP-së, raporti në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit, pra të gjitha kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, duke bërë një analizë të kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit, llojit të autoriteteve kontraktuese, sipas llojit të kontratave, vlerës së kontratave, procedurave të përdorura, aneks kontratave, operatorëve ekonomikë të shpërblyer me kontratë, afateve kohore të publikimit dhe kritereve të shpërblimit me kontratë.

Pra, raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2019 në Kosovë, duke i analizuar dhe duke i krahasuar me vitet paraprake, me ç'rast do ta shohim trendin e zhvillimit të Prokurimit Publik në Kosovë.

5.1. NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2019

NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA				
Autoritetet kontraktuese	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	**Viti 2019**[1]
Qeveritare	8194	7452	9074	**9216**
Kompani publike	1806	2751	3335	**3225**
Tjera/OJQ	15	11	3	**20**
Gjithsej	**10015**	**10214**	**12412**	**12461**

Tabela 1

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, autoritetet kontraktuese janë të obliguara t'i paraqesin të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale.

Analiza e kontratave të nënshkruara fillohet me ndarjen e autoriteteve kontraktuese në organizata buxhetore – Qeveritare, Kompani publike dhe të Tjera-OJQ. Duke u bazuar në këtë ndarje, në *Tabelen 1 dhe Grafikonin Nr.1* pasqyrohet numri i kontratave të nënshkruara gjatë katër viteve të fundit nga autoritetet kontraktuese në fjalë.

[1] Në numrin e kontratave të nënshkruara janë përfshirë edhe 297 aneks kontrata dhe tw gjitha kontratat me vlerw minimale (deri nw 1000 Euro)



Grafikoni 1

5.2. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2019

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA (€)				
Autoritetet kontraktuese	**Vlera e kontratave 2016**	**Vlera e kontratave 2017**	**Vlera e kontratave 2018**	**Vlera e kontratave 2019[2]**
Qeveritare	359,747,327.33	354,478,891.29	533,708,962.76	**648,915,705.35**
Kompani publike	62,063,637.36	103,084,640.60	97,519,718.76	**129,081,829.61**
Tjera/OJQ	2,763,414.33	2,226,414.05	394,004.50	**3,398,500.08**
Gjithsej	**424,574,379.02**	**459,789,945.94**	**631,622,686.02**	**781,396,035.04**

Tabela 2

[2] Në vlerën e kontratave të nënshkruara është përfshirë edhe vlera e aneks kontratave në vlerë prej: **13,088,039.786**

Në bazë të klasifikimit të autoriteteve kontraktuese, si më lartë në *tabelën nr. 2 dhe grafikonin nr. 2*, pasqyrohet vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë katër viteve të fundit.



Grafikoni 2

Grafikoni nr.3 e pasqyron strukturën, apo pjesëmarrjen e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019. Organizatat buxhetore - Qeveritare marrin pjesë me 83.05%, Kompanitë publike me 16.52%, derisa te autoritetet Tjera – OJQ - të me vetëm 0.43% në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara.



Grafikoni 3

PJESËMARRJA E VLERËS SË KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË BRUTO PRODUKTIN VENDOR (BPV[3] = 7, 123, 000, 000.00) GJATË VITIT 2019



Grafikoni 4

[3] Burimi: *Ministria e Integrimit Evropian*

NUMRI TOTAL DHE VLERA FINANCIARE E KONTRATAVE VJETORE PËRMES PROCEDURAVE TË PROKURIMIT MBI PRAGJET FINANCIARE TË BE-së GJATË VITIT 2019

NUMRI TOTAL DHE VLERA FINANCIARE E KONTRATAVE VJETORE PËRMES PROCEDURAVE TË PROKURIMIT MBI PRAGJET FINANCIARE TË BE-SË (€)		
Lloji i kontratave:	**Vlera e kontratave**	**Numri i kontratave**
Furnizime: *(Mbi 144,000.00)*	**162,573,204.15**	**226**
Shërbime: *(Mbi 144,000.00)*	**80,802,956.78**	**126**
Konkurs i projektimit: *(Mbi 144,000.00)*	**0.00**	**0**
Punë: *(Mbi 5,548,000.00)*	**64,941,397.01**	**7**
Gjithsejt:	**308,317,557.94**	**359**

Tabela 3

5.3. VLERA E KONTRATAVE TË NËSHKRUARA GJATË VITIT 2019 SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT (€)				
Burimet e financimit	Vlera e kontratave 2016	Vlera e kontratave 2017	Vlera e kontratave 2018	Vlera e kontratave 2019
Të hyrat vetanake[4]	60,066,595.11	97,873,515.49	134,266,540.98	**129,081,829.61**
Buxheti i Kosovës	352,092,401.45	351,580,882.16	496,962,140.54	**648,915,705.35**
Donacione	12,415,382.46	10,335,548.29	394,004.50	**3,398,500.08**
Gjithsej	**424,574,379.02**	**459,789,945.94**	**631,622,686.02**	**781,396,035.04**

Tabela 4



Grafikoni 4

Në tabelën nr. 4 dhe grafikonin nr. 4 është pasqyruar vlera e kontratave të nënshkruara, duke pasur për bazë burimin e financimit. Nga të hyrat vetanake vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019 është 129, 081, 829.61€. Nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës vlera e kontratave të nënshkruara arrin 648, 915, 705.35€, derisa nga donacionet vlera e kontratave të nënshkruara arrin 3, 398, 500.08€.

[4] Të hyrat vetanake paraqesin të hyrat e Kompanive Publike



Grafikoni 5

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit pasqyrohet në grafikonin nr.5 ku të Hyrat vetanake të kompanive marrin pjesë me 16.52%, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës me 83.05%, kurse nga donacionet me 0.43%.

5.4. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2019 SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT (€)				
Lloji i prokurimit	Vlera e kontratave 2016	Vlera e kontratave 2017	Vlera e kontratave 2018	**Vlera e kontratave 2019**
Furnizim	190,926,041.02	159,713,785.04	181,870,671.15	**235,430,873.96**
Shërbime[5]	58,915,351.43	55,688,897.04	92,320,204.14	**111,247,767.38**
Konkurs i projektimit	512,710.03	886,142.00	554,212.40	**648,304.00**
Punë	174,220,276.54	243,501,121.86	356,877,598.33	**434,069,089.70**
Gjithsej	**424,574,379.02**	**459,789,945.94**	**631,622,686.02**	**781,396,035.04**

Tabela 5

Bazuar në llojin e prokurimit, që kontratat kanë si objekt të tyre, në tabelën nr. 5 dhe grafikonin nr. 6, vlera e kontratave të nënshkruara për furnizime gjatë vitit 2019 arrin në 235, 430, 873.96€. Vlera e kontratave të nënshkruara për shërbime është 111, 247, 767.38€, dhe vlera e kontratave të nënshkruara për konkurs projektimi është 648, 304.00€. Ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara për punë arrin në 434, 069, 089.70€.

[5] Në vlerën e kontratave për shërbime janë përfshirë edhe shërbimet e konsulencës.



Grafikoni 6

Grafikoni nr 7, paraqet strukturën, apo pjesëmarrjen e kontratave të nënshkruara, sipas vlerës në totalin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019.



Grafikoni 7

Kontratat për furnizime marrin pjesë me 30.13%, kontratat për shërbime me 14.24%, kontratat për konkurs të projektimit me 0.08%, ndërsa kontratat për punë marrin pjesë me 55.55%.

5.5 KONTRATAT E NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2019 SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT (€)				
Lloji i vlerës së prokurimit	Vlera e kontratave 2016	Vlera e kontratave 2017	Vlera e kontratave 2018	**Vlera e kontratave 2019**
Vlerë e madhe	260,921,281.88	275,854,900.58	443,215,634.22	**553,935,201.43**
Vlerë e mesme	150,795,136.06	170,092,960.74	172,588,576.84	**210,746,301.72**
Vlerë e vogël	10,214,128.42	11,003,741.55	11,746,993.37	**12,885,351.93**
Vlerë minimale	2,643,832.66	2,838,343.07	4,071,481.59	**3,829,179.96**
Gjithsej :	424,574,379.02	459,789,945.94	**631,622,686.02**	**781,396,035.04**

Tabela 6

Kontratat e nënshkruara, të ndara sipas llojit të vlerave të kontratave, në tabelën nr. 5 dhe në grafikonin nr.9, na pasqyrojnë se, sipas vlerës së madhe, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019 është 553,935,201.43€.



Grafikoni 9

Kontratat e nënshkruara me vlerë të mesme arrijnë shumën prej 210,746,301.72€, vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë të vogël është 12,885,351.93€, derisa vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë minimale është 3,829,179.96€.



Grafikoni 10

Në bazë të *grafikonit nr.10*, vërehet se pjesëmarrja e kontratave me vlera të mëdha, në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019, është 70.89%. Kontratat me vlera të mesme marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 26.97%. Kontratat me vlerë të vogël marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 1.65%, derisa kontratat me vlerë minimale marrin pjesë me 0.49%.

5.6 VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2019 SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT (€)				
Lloji i procedurave:	Vlera e kontratave 2016	Vlera e kontratave 2017	Vlera e kontratave 2018	Vlera e kontratave **2019**
Procedurë e hapur	357,489,373.44	400,232,896.14	559,457,758.80	**690,524,312.30**
Procedurë e kufizuar	2,210,137.48	3,443,042.82	3,835,107.58	**4,917,179.96**
Konkurs projektimi	296,373.45	713,569.56	439,267.14	**977,714.20**
Procedurë konkurruese me negociata	185,010.34	0.00	0.00	**330,247.46**
E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	51,458,447.72	42,164,760.65	51,658,934.60	**68,443,389.16**
Kuotimi i çmimeve	10,149,794.32	10,398,703.61	12,123,641.88	**12,356,308.94**
Procedurë për vlerë minimale	2,785,242.27	2,836,973.16	4,107,976.02	**3,846,883.02**
Gjithsej :	**424,574,379.02**	**459,789,945.94**	**631,622,686.02**	**781,396,035.04**

Tabela 7

Analiza e kontratave të nënshkruara,të ndara sipas llojit të procedurave në *tabelën nr.7* dhe në *grafikonin nr.11*, tregon se vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur gjatë vitit 2019 është 690,524,312.30€, derisa sipas procedurës së kufizuar gjatë vitit 2019 4,917,179.96€.

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës konkurs projektimi, gjatë vitit 2019,është 977,714.20€,derisa vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës ,gjatë vitit 2019,Procedurë konkurruese me negociata është 330,247.46€. Kurse sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës është 68,443,389.16€ dhe vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës kuotim i çmimeve, gjatë vitit 2019, është 12,356,308.94€.

Ndërkaq, sipas procedurës për vlerë minimale, vlera e kontratave të nënshkruara,gjatë vitit 2019,është 3,846,883.02€.

	Procedura e hapur	Procedura e kufizuar	Konkurs projektimi	Procedurë konkurruese me negociata	E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	Kuotimi i çmimeve	Procedurë për vlerë minimale
Viti 2016	357,489,373.4	2,210,137.48	296,373.45	185,010.34	51,458,447.72	10,149,794.32	2,785,242.27
Viti 2017	400,232,896.1	3,443,042.82	713,569.56	0.00	42,164,760.65	10,398,703.61	2,836,973.16
Viti 2018	559,457,758.8	3,835,107.58	439,267.14	0.00	51,658,934.60	12,123,641.88	4,107,976.02
Viti 2019	690,524,312.3	4,917,179.96	977,714.20	330,247.46	68,443,389.16	12,356,308.94	3,846,883.02

Grafikoni 11



Grafikoni 12

Analiza e strukturës, apo e pjesëmarrjes së procedurave të zbatuara gjatë vitit 2019, në grafikonin nr. 12, na tregon se pjesëmarrja e procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 88.37%, e cila është nga procedurat e përdorura më së shumti dhe e njohur si procedura më transparente.

Gjithashtu edhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës është 3,846,883.02%. Dhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës gjatë vitit 2018 është 8.76%.

Pjesëmarrja e procedurave sipas kuotimit të çmimeve është 1.58% dhe sipas vlerës minimale merr pjesë me 0.49%, e kufizuar 0.63%, kurse konkurset e projektimit marrin pjesë vetëm me 0.13% në vlerën e kontratave të gjithëmbarshme të nënshkruara gjatë vitit 2019.

Në grafikonin 12.a me qellim te analizave me detale eshte paraqitur vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit per kontrate (duke mos perfshire kontratat per **punë shtesë**), pra puna shtesë nuk janë perfshire (ato janë trajtuar si procedure e hapur meqë rrjedhin nga nje aktivitet i procedurave të hapura). Andaj pjesëmarrja e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës (pa perfshire kontrata shtese) gjatë vitit 2019 është **7.08%.**



Grafikoni 12.a



Grafikoni 13

Grafikoni 13 pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit te organizatat buxhetore apo Qeveritare. Derisa grafikoni 14 pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit te Kompanitë Publike dhe grafikoni 15 paraqet perdorimin e procedurave të prokurimit te organizatat tjera- OJQ-të.



Grafikoni 14



Grafikoni 15

5.7 KONTRATAT E NËNSHKRUARA DHE ANEKS-KONTRATAT GJATË VITIT 2019

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA DHE ANEKS-KONTRATAVE GJATË VITIT 2017,2018 DHE 2019 (€)						
Kontratat:	**Vlera 2017(€)**	Pjesëmarrja 2017 (%)	**Vlera 2018(€)**	Pjesëmarrja 2018 %	**Vlera 2019(€)**	Pjesëmarrja 2019 (%)
Kontratat e nënshkruara	455,841,372.07	**99.14**	622,272,616.48	98.52	**768,308,004.26**	**98.33**
Aneks - kontratat	3,948,573.87	**0.86**	9,350,069.54	1.48	**13,088,030.78**	**1.67**
Gjithsej	**459,789,945.94**	**100.00**	**631,622,686.02**	**100.00**	**781,396,035.04**	**100.00**

Tabela 8

Grafikoni 16

Siç shihet nga tabela e mësipërme nr.8 dhe grafikoni nr.16, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019 është 768,308,004.26€, me një pjesëmarrje prej 98.33% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 781,396,035.04€, kurse vlera e aneks kontratave arrin në 13,088,030.78€, apo me pjesëmarrje 1.67% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 781,396,035.04€.

5.8 VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS OPERATORËVE EKONOMIK VENDORË DHE JO-VENDORË

Nga analiza e bërë vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019, të ndara sipas shpërblimit me kontratë në operatorë ekonomik **Vendor**, pjesëmarrja në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 97.91%. Derisa operatorët **Jo-Vendor** pjesëmarrja në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 2.09%.

STRUKTURA E VLERËS SË KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2019 SIPAS OPERATORËVE EKONOMIK VENDORË - JO-VENDOR			
Operatorët Ekonomik:	**Numri i kontratave:**	**Vlera e kontratave:**	**Pjesëmarrja %**
OE: **Vendor**	**12291**	**765,035,620.42**	**97.91**
OE: **Jo-Vendor**	**170**	**16,360, 414.62**	**2.09**
Gjithësejt :	**12461**	**781, 96,035.04**	**100.00**

Tabela 9



Grafikoni 17

5.9 VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS AFATIT KOHOR PËR PUBLIKIM GJATË VITIT 2019

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS AFATIT KOHOR TË PUBLIKIMIT GJATË VITIT 2017,2018 DHE 2019 (€)						
Afatet e publikimit:	Vlera e kontratave 2017	Pjesëmarrja %	Vlera e kontratave 2018	Pjesëmarrja %	Vlera e kontratave 2019	Pjesëmarrja %
Afate normale kohore	437,188,568.83	95.08	577,511,949.92	91.43	673,828,876.64	**86.23**
Shkurtim i afatit	22,601,377.11	4.92	54,110,736.10	8.57	107,567,158.40	**13.77**
Gjithsej	**459,789,945.94**	100.00	631,622,686.02	100.00	**781,396,035.04**	**100.00**

Tabela 10

Të dhënat në *tabelën nr.10*, vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese me afate normale kohore të publikuara është 673, 828, 876.64€ dhe me pjesëmarrje prej 86.23% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019. Kurse vlera e kontratave të nënshkruara të publikuara me afat të shkurtuar arrin në 107, 567, 158.40€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 13.77 % në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019.

5.10 VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KRITERIT PËR DHËNIE KONTRATE GJATË VITIT 2019

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KRITERIT PËR DHËNIE GJATË VITIT 2017,2018 DHE 2019(€)						
Kriteret për dhënie kontrate	Vlera e kontratave 2017	Pjesëmarrja (%)	Vlera e kontratave 2018	Pjesëmarrja (%)	Vlera e kontratave 2019	Pjesëmarrja (%)
Çmimi më i ulët	451,362,240.52	98.17	625,401,425.24	99.02	775,304,750.28	**99.22**
Si pjesë e kapaciteteve më të qëndrueshme të trajnimit, KRPP-ja tani po e krijon këtë mekanizëm trajnimi online, duke ecur drejt një sistemi për trajnimin e zyrtarëve publikë, veçanërisht atyre të

sapo punësuar, me shkathtësitë e nevojshme për punën e tyre të prokurimit në mjedis modern të prokurimit elektronik. Ky udhëtim drejt vetë-mbështetjes kulmoi me ngjarjen e madhe te 24 majit ku KRPP-ja hodhi në përdorim videot e reja të trajnimit për zyrtarët publikë dhe operatorët ekonomikë të sektorit privat.
Pra me 24 maj 2019, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) me mbështetje nga USAID-i lansoi video trajnimet që udhëzojnë shikuesit për përdorimin e platformës së prokurimit elektronik.
Përgatitja dhe zhvillimi i video- trajnimeve të cilat shënojnë risi në mënyrën e ofrimit të trajnimeve nga KRPP-ja, ku krahas sistemit klasik të trajnimeve, të interesuarit tanimë do të kenë qasje në videot trajnuese për e-Prokurim nga zyrat apo hapësirat e tyre në çfarëdo kohe.
Të gjithë zyrtarët qeveritarë të cilët janë të ngarkuar me zbatimin e procedurave të duhura të prokurimit do të jenë në gjendje të përfitojnë dhe të mësojnë nga këto video trajnime.
Në mënyrë të ngjashme, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile do të përdorin videot e trajnimit online për të mësuar si mund ta regjistrojnë subjektin e tyre në platformën e prokurimit elektronik si mund të përgatisin dosjen e tenderit për një aktivitete të prokurimit , përgatitjen e ofertës dhe dorëzimin e saj në Autoritet kontraktues , procesin e hapjes dhe të Vlerësimit të aktiviteteve të prokurimit , përgatitjen e njoftimit për dhënie të kontratës , për nënshkrim të kontratës, parashtrimin e kërkesave për sqarime të dosjeve të tenderi , kërkesave për rishqyrtim dhe paraqitjen e Ankesave në AK dhe në OSHP përmes platformës së Prokurimit.
Video trajnimet gjenden në kuadër të platformës së e-Prokurimit dhe në seksionin e udhëzuesve të trajnimit në ueb-faqen e KRPP-së, duke promovuar qëndrueshmërinë afatgjatë dhe adoptimin më të plotë të platformës së e-Prokurimit.

Bashkëpunimi

KRPP-ja gjatë vitit 2019 ka bashkëpunuar dhe koordinuar aktivitet me disa institucione, organizata partnere, donator. Në të gjitha këto bashkëpunime – aktivitete janë implementuar programe trajnimi për nevoja të zyrtareve të prokurimit dhe zyrtarëve të tjerë të institucioneve.
Megjithëse me kapacitet shume të kufizuara në personel dhe në salla trajnimi, Dep. për trajnime ka arrit të siguroj përkrahje të çmuar për të plotësuar programin - planin e saj të trajnimit gjatë vitit 2019 nga mbështetësit e vetë si IKAP dhe USAID. Përkrahja e siguruar nga partneret ishte financimi i plot, financim i pjesshëm, në disa raste kishim edhe bashkëpunim në implementim.

Përmbyllja dhe Përfundimi

Rezultatet e bashkëpunimit dhe koordinimit te trajnimeve evidentojnë faktin se ky vit ishte produktiv, indikatorët evidentojnë se në ketë vitë janë qertifikuar 372 zyrtarë të prokurimit nëpërmjet programit të Avancuar profesional të trajnimit.

Gjatë këtij viti, në trajnime janë përfshirë Zyrtaret e prokurimit përafërsisht të mbi 150 njësive dhe organizatave publike , të mbi 50 Kompanive publike dhe OSHC . Përfitues të trajnimeve ishin Zyrtaret nga niveli Qendror, Lokal, Organizatat e Shoqërisë Civile , Zyrtaret e prokurimit te Agjencioneve të pavarura, kompanitë publike dhe një numër i organizatave të tjera.

Sigurimi i trajnimeve kualitative dhe te përshtatshme me nevojat është arritur duke u fokusuar ne zbatimin e prioriteteve të dokumenteve ligjore e strategjike përmes zbatimit të metodologjive të avancuara të mësimit për të rritur dhe ilustrimit të shembujve praktik gjatë trajnimit .

KRPP, si njëra nga organet qendrore në fushën e prokurimit publik, që është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik në Kosove, ka edhe përgjegjësitë kryesore për proceset e Integrimit Evropian në fushën e prokurimit publik.
Komfor kompetencave dhe përgjegjësive të dhëna me LPP , KRPP-ja duhet të ndër veprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik. Në këtë konteste Departamenti për trajnime dhe integrime - KRPP në vazhdimësi ka mbajtur takime, ka raportuar dhe bashkëpunuar sa i përket fushës së prokurimit publik në MIE, MF, DIEKP, OECD-SIGMA dhe institucionet tjera.
Përmes këtyre takimeve, raportimeve dhe bashkëpunimeve është synuar që të pasqyrohet puna dhe gatishmëria e KRPP-së karshi Institucioneve Qeveritare dhe institucioneve ndërkombëtare si Zyra e BE-së, SIGMA, Banka Botërore dhe OJQ .
Gjate vitit 2019 janë kryer këto raportime siç janë : Raportime të rregullta dhe takime për Programin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së (PKZMSA), Raportimet rreth zbatimit të PKZMSA-së për vitin 2019, si në matricën e raportimit ashtu edhe në dokumentin narrativ dhe rishikimin e PKZMSA-së për vitin 2020, Raportime të rregullta në MIE për Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2019, Raportim vjetor në Vlerësimin e SIGMA-së, etj.

5.15.4 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË TI-së DHE PROKURIMI ELEKTRONIK

a) Aktivitetet e Departamentit të TI-së

Aktiviteti i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit me të gjitha kapacitetet është fokusuar plotësisht në:

- Administrimin e përditshëm të infrastrukturës harduerike dhe softuerike të sistemit të prokurimit elektronik, parandalimin, evitimin dhe zgjidhjen e problemeve për të siguruar qëndrueshmëri dhe operim të pandërprerë të Sistemit të Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës;
- Bashkëpunim dhe koordinim me institucionet e Ministrisë së Administratës Publike/Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrisë së Financave, si institucione të përfshira në mënyrë indirekte në operim të sistemit të prokurimit elektronik;
- Ofrim të shërbimeve në dhënie të ndihmës teknike dhe instruksioneve nëpërmjet tavolinës ndihmëse (linjë telefonike, postë elektronike dhe prezencë fizike) për të gjithë përdoruesit e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik gjatë përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik;
- Dhënie e ndihmës teknike dhe mbështetjes për të gjithë stafin e KRPP-së, departamentin e rregullave, monitorimit dhe trajnimeve, në funksion të rritjes së njohurive në përdorim të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik dhe transformimit nga prokurimi tradicional në atë elektronik;
- Pasurim i dy portaleve të KRPP-së, https://krpp.rks-gov.net/ dhe https://e-prokurimi.rks-gov.net/, me informacione, pyetje të shpeshta, njoftime dhe vendime të përgatitura nga KRPP dhe publikuar për publikun e gjerë.

b) Aktivitetet nga Sistemi i Prokurimit Elektronik

Gjatë vitit 2019 sistemi i prokurimit elektronik ka qenë funksional dhe në operim të plotë për zhvillim të të gjitha aktiviteteve të prokurimit (me vlerë mbi 1000 Euro) në formë elektronike nga ana e autoriteteve kontraktuese, dhe në funksion të plotë të përgaditjes dhe dorëzimit të ofertave në formë elektronike nga të gjithë operatorët ekonomik të rexhistruar në sistem të prokurimit elektronik.
Gjatë vitit 2019, si aktivitete kryesore të evidentuara në përdorim të sistemit të prokurimit elektronik, janë:

- Nga **1 Janari 2019** të gjitha ofertat në aktivitete të prokurimit (me vlerë mbi 1000 Euro) janë përgaditur dhe dorëzuar nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik
- Të gjitha **(190)** AK janë të regjistruara dhe përdorin platformën e prokurimit elektronik
- Ka arritur në rreth **7, 650** numri i OE të regjistruar të cilët përdorin platformën në mënyrë aktive
- Numri i të gjithë përdoruesve të regjistruar ka arritur në rreth **20,500**

- **21,000** publikime të të gjitha llojeve (në 2019) nga **54,000** publikime që deri më tani janë pjesë e platformës;
- **7, 627** procedura të prokurimit janë zhvilluar (përgaditur dhe publikuar), nga të cilat rreth
  5,630 kanë përfunduar me nënshkrim kontrate;
- Të gjitha publikimet në prokurim elektronik janë transparente publike dhe të qasshme për cdo palë të interesit, përfshirë kontratat e nënshkruara dhe dokumentet mbi vlerësimin e ofertave të eliminuara dhe shpërblyera (vendimet e AK-se mbi vleresimin e ofertave dhe letrat standarde per tenderuesit e sukseshhëm dhe të eleminuar);
- Është reduktuar në maximum kontakti fizik i zyrtarëve të prokurimit me OE potencial pjesëmarrës në procedura të prokurimit;
- Është mundësuar monitorimi i aktivitetetve të prokurimit në kohë reale dhe në cilëndo fazë të aktivitetit – nga na e monitorimit të KRPP-së,
- Është mundësuar qasja në sistem për auditorët e brendshëm dhe të jashtëm për ta përdorur sistemin për auditim të të gjitha aktiviteteve të prokurimit të zhvilluara dhe përfunduara nëpërmjet sistemit të prokurimit;
- Platforma e prokurimit elektronik është nga sistemet më të përdorura në nivel qeveritar, të perdorura nga bizneset, qytetarët dhe cilado palë e interesit;
- Sistemi i prokurimit elektronik është përdorur plotësisht për përgaditje, procesim dhe trajtim të ankesave në OSHP, përfshirë përgaditjen dhe procesimin e kërkesave për sqarime dhe kërkesave për rishqyrtim nga an e OE;
- Është bërë publikimi i rregullt në portalin qeveritar https://opendata.rks-gov.net/ i të gjitha kontratave të nënshkruara nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik;
- Statistikat mbi aktivitetin e përgatitjes së procedurave të prokurimit, publikimit të njoftimeve dhe ofertave të dorëzuara gjate vitit 2019 janë dhënë si me poshtë:

Statistikat e publikimeve të të gjitha njoftimeve dhe ofertave të dorëzuara gjatë vitit 2019	
Lloji i njoftimit	**Numri**
Njoftim paraprak	**71**
Njoftim për kontratë (B05)	**7142**
Njoftim standard për korrigjim të gabimeve në njoftimet e publikuara (B54)	**947**
Njoftim për konkurse të projektimit (B06)	**47**
Njoftim për dhënie të kontratës (B08)	**5961**
Njoftim për nënshkrim të kontratës (B52)	**5630**[7]
Njoftim për rezultatet e konkursit të projektimit (B09)	**31**
Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit (B11)	**1893**[8]
Oferta të dorëzuara nga OE në të gjitha aktivitetet e prokurimit	**30, 500**

[7] **485** njoftime i takojne procedurave të negociauara pa publikim të njoftimit për kontratë

[8] **26%** është përqindja totale e anulimeve, nga të cilat **15%** - i takon anulimeve të aktivitetit të prokurimit në tërësi, ndërsa **11%** anulimeve të pjesshme të aktiviteteve të prokurimit (anulim të njërit nga LOT-et e aktivitetit).

c) Aktivitetet në funksion të përmirësimit të Sistemi i Prokurimit Elektronik

Nga aktivitetet e vitit 2019 që janë në funksion të përmirësimit të sistemit të prokurimit elektronik, duhet vecuar:

- Blerja, furnizimi dhe implementimi i paisjeve harduerike për ngritjen një infrastrukture të re të sistemit të prokurimit elektronik; dhe
- Zhvillimi dhe implementimi i moduleve të reja të sistemit te prokurimit elektronik, sic janë: i) moduli për menaxhim të implementimit të kontratave, dhe ii) moduli për vlerësim të performancës se kaluar të kontraktuesve, të cilat module janë duke u zhvilluar dhe implementuar nëpërmjet një kontrate të mbështetur nga projekti i USAID/TEAM.

Blerja dhe furnizimi i paisjeve të reja harduerike është bërë gjatë vitit 2019, derisa implementimi dhe vënia në funksion e infrastrukturës së re për sistem të prokurimit elektronik do të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2020.

Derisa, zhvillimi, implementimi, testimi dhe faza e pilotimit të moduleve të reja, modulit për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performancës së kontraktuesve, parashikohet të përmbyllet gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, ndërsa vënia në përdorim të plotë nga të gjitha autoritetet kontraktues është paraparë të bëhet ne gjysmën e dytë të vitit 2020.

6. PËRKRAHJA E SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË NGA INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2019, njejtë si në vitet paraprake është vazhduar përkrahja e sistemit të prokurimit publik nga USAID nëpërmjet projektit TEAM (Transparenca, Efikasiteti dhe Llogaridhenia ne Komuna). Përkrahja e projektit TEAM ka përfshirë nivelin qëndrorë (KRPP-në) dhe nivelin lokal (komunat).

Në nivelin qëndror përkrahja e projektit është fokusuar në:

- Mbështetjen e KRPP-së me ekspertë të TI-së, me qellim të shkëmbimit të ekspertizës dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit të TI-së përgjegjës për sistem të prokurimit elektronik;
- Përkrahje financiare në zhvillim të moduleve dhe funksionaliteteve të reja të sistemit të prokurimit elektronik, si:
  a) moduli për menaxhim të implementimit të kontratave **dhe**
  b) ***moduli për vlerësim të performancës se kaluar të kontraktuesve.***
- Mbështetje në përgaditjen dhe finalizimin e video – tutorialeve që udhëzojnë dhe përdorim të sistemit të prokurimit elektronik nga ana e përdoruesve të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik.

Në nivelin lokal (komunat) përkrahja e projektit gjatë vitit 2019 ka patur një shtrirje më të gjerë në krahasim me vitet paraprake dhe kjo përkrahje edhe më tutje është fokusuar në:

- Ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të prokurimit në komunat fokus (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Gjilan dhe Vushtrri) dhe në disa komuna të tjera nëpërmjet angazhimit të përhershëm të ekspertëve të prokurimit, të cilët ndihmojnë dhe asistojnë zyrat e prokurimit që të zhvillojnë procedura të prokurimit në mënyrë sa më efikase dhe transparente,

Vlenë të theksohet që nga përkrahja më e rëndësishme dhe e shënuar gjatë vitit 2019 të projektit TEAM, është përkrahja në zhvillim të moduleve dhe funksionaliteteve të reja të sistemit të prokurimit elektronik, moduli për menaxhim të kontratave dhe moduli për vlerësim të performancës së kontraktuesve, të cilat module do bëhen pjesë e sistemit të prokurimit elektronik, duke e pasuruar prokurimin elektronik me vegla për administrim të implementimit të kontratave dhe vlerësim të performancës së implementimit te kontratave nga ana e kontraktuesve. Me vënien në përdorim të këtyre moduleve të reja, do të synohet që të rritet niveli i llogaridhënies në implementim të kontratave të nënshkruara nëpërmjet prokurimit publik dhe do ofrohet në kohë reale një pasqyrë e statusit të implementimit të të gjitha kontratave me vlerë mbi 10,000 Euro.

Sipas planeve të zhvillimit dhe implementimit të këtyre moduleve, parashikohet që këto module të futen në përdorim të plotë nga gjysma e vitit 2020.

6.1 REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË

Sipas Nenit 87.2.13, të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04/L-042, KRPP-ja së bashku me raportin vjetor në Qeveri dhe Kuvend duhet të dorëzojë edhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji.

Qëllimi/objektivat dhe rekomandimet

Qeveria e Kosovës përkatësisht KRPP si Institucion i autorizuar për fushën legjislative në Prokurimin Publik ka përcaktuar objektiva konkrete në këtë fushë. Objektivi dhe synimi kryesore i Qeverisë si edhe i KRPP-së, ka qenë dhe mbetet avancimi i sistemit të prokurimit publik në Kosovë, me qëllim të ngritjes së **transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies** nga të gjithë aktorët të cilët janë të përfshirë në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit publik. Funksionimi i sistemit të prokurimit publik paraqet një çështje thelbësore të menaxhimit të financave publike për administratën publike në Kosovë dhe një sistem i mirëfilltë i prokurimit publik mundëson shfrytëzimin më efikas dhe më të arsyeshëm të fondeve publike, duke mundësuar kursime substanciale të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, si dhe duke kontribuar ndjeshëm në luftimin e korrupsionit, keqpërdorimeve e njëkohësisht edhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Aktualisht, fusha e prokurimit publik në Kosove rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Arritja e rezultateve të plota të përcaktuara me këtë Strategji nuk është e mundur pa përfunduar edhe reformën legjislative dhe harmonizimin e saj me zhvillimet e fundit në fushën e prokurimit publik.

Ka qenë dhe mbetet edhe me tej zotim i Qeverisë dhe Institucioneve tjera të Republikës së Kosovës (përfshirë KRPP-në), që sistemi i prokurimit publik në vazhdimësi të avancohet duke ngritur transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien nga të gjithë akterët që merren me kryerjen e aktiviteteve të prokurimit publik në Kosovë. Avancimi i mëtejmë i kornizës ligjore në fushën e prokurimit publik mbetet një nga nevojat më me prioritet e cila ndërlidhet edhe me Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, Agjendës për Reforma Evropiane si dhe nga standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Projekti për modernizimin e sektorit publik, me theks ne fushën e prokurimit elektronik, është në fazën implementimit të plotë dhe përbën njërën ndër reformat më të rëndësishme dhe më të mëdha në fushën e prokurimit publik deri më tani. Nga vlerësimet e deritanishme nga përdoruesit e sistemit, nga partnerët ndërkombëtar por edhe ata vendorë, ky proces edhe pse kishte sfida të mëdha është vlerësuar me notën maksimale. Mirëpo, procesi i implementimit të plotë të kësaj reforme duhet të përcillet edhe me **reformimin/ndryshimet në fushën legjislative,** e cila është paraparë edhe me Strategjinë Kombëtare për Prokurim Publik (2017-2021). Kjo ka rëndësi tejet të madhe sepse arritja e objektivave strategjike me reformën e ndërmarrë (rritja e transparencës dhe efektivitetit me

qëllim të rritjes së veprimeve në luftën kundër korrupsionit dhe keqpërdorimit) nuk mund të bëhet pa reformën legjislative dhe harmonizimin e saj me zhvillimet tjera. KRPP për shkak të angazhimeve tepër te mëdha në fazën e tranzicionit nga prokurimi tradicional në atë elektronik, në agjendën e ndryshimeve ligjore, ka mbetur mbrapa (ndryshimet ligjore ishin paraparë në vitin 2017/18). **Për këtë qëllim, KRPP e konsideron tejet të rëndësishme dhe prioritet të shkallës së lartë inicimin dhe përfundimin sa më të shpejtë të ndryshimeve ligjore.**

Gjate vitit 2019 KRPP ka qene e angazhuar fuqimisht ne pergatitjen e Koncept Dokumentit per Ndryshime Ligjore i cili tashme eshte finalizuar dhe protet ti dergohet Qeversie se Republikes ne momentin per te cilin do te krijohen kushtet e nevoshjme. Ne menyre detale Koncep Dokumenti pershkruan ne hollesi arsyet dhe/ose rekoamndimet per Qeverine dhe Institucionet tjera per nevojen e reformes ligjore. Ne vazhdim do te pershkruhen vetem disa nga rekomandimet e cekura edhe ne Koncept Dokumentin per ndryshimet ligjore.

Arsyet për reformen ligjore dhe rekomandimi:

1. Harmonizimi i plotë i legjislacionit me përdorimin e mjeteve elektronike (e-prokurimin).
   Sipas LPP-së në fuqi (neni 129 Prokurimi elektronik), KRPP është e autorizuar të nxjerr rregulla përkatëse të cilat mundësojnë përdorimin e mjeteve elektronike. Mirëpo, duke pas parasysh se legjislacioni si tërësi është i dizajnuar për prokurimin tradicional, ka shumë provizione ligjore të cilat pengojnë nxjerrjen e rregullave adekuate për përdorimin e mjeteve elektronike. Kjo ndodhe sepse sa do që KRPP është e autorizuar të nxjerrë rregulla tjera të cilat e mundësojnë përdorimin e mjeteve elektronike (neni 129 i LPP-së), KRPP nuk mund të nxjerrë as një rregull e cila mund të derivojë një provizion të ligjit. Për këtë qëllim platforma e prokurimit elektronik ka synuar plotësimin e të gjitha dispozitave të LPP-së e për disa prej tyre ndryshimi dhe përshtatja biznes proceseve të përdorimit të mjeteve elektronike do të thotë më shumë transparencë, efikasitet dhe më pak mundësi për keqpërdorime. Me theks të veçantë janë nenet 26, paragrafi 4, pika 1, Neni 36 në tërësi, nenet 41, 41A dhe 42 po ashtu në tërësi, neni 48 po ashtu në tërësi, neni 50 pjesërisht, nenet 54, 58, 68 etj.

2. Dinamika e zhvillimeve në TI dhe prokurim publik
   Bazuar në dinamikën e shpejtë të zhvillimeve në teknologjinë informative, është thelbësore përcjellja e tyre edhe me ndryshimet ligjore. Proceset e ndryshimeve ligjore janë tejet të komplikuara dhe kërkojnë kohë për tu ndryshuar andaj dizajnimi i një ligji i cili mundëson rregullimin e shumë aspekteve teknike, proceseve fleksibile dhe të aplikimit të praktikave më të reja në prokurimin publik përmes legjislacionit sekondar është mëse i nevojshëm. Në të gjitha sistemet të cilat kanë kaluar në fazën e përdorimit të prokurimit elektronik, adaptimet e tilla ligjore janë bërë, andaj edhe Kosova duhet të adaptojë sistemin e tij legjislativ me zhvillimet e fundit-përdorimin e mjeteve elektronike.

3. Harmonizimi me direktivat e reja
   Po ashtu një faktor tjetër i rëndësishëm për inicimin e ndryshimeve ligjore është harmonizimi i legjislacionit me Direktivat e reja të BE-së (Direktivat e 2014). Janë një sërë

dispozitash të reja të cilat me Direktivat e BE-së, kërkohet të transpozohen në legjislacionet nacionale.

4. Eliminimi i dobësive të identifikuara gjatë zbatimit praktik të ligjit aktual

KRPP, në vazhdimësi monitoron zbatimin në praktikë të dispozitave të LPP-së dhe si rezultat janë vërejtur dobësi në aspektin rregullativ ligjor të cilat mund të evitohen vetëm me ndryshimet ligjore. P.sh njëra ndër dobësitë e identifikuara është sistemi i ankimimit në kuptimin e nenit 108A dhe/ose Kreut III dhe IV të LPP-së. Gjithashtu, edhe një numër i konsiderueshëm i dispozitave të LPP-së konsiderohen të nevojshme të ndryshohen sa më shpejt, në mënyrë që të sigurohet rritja e Transparencës dhe Efikasitetit të shfrytëzimit të parasë publike. KRPP ka arritur që me sukses të përmbyll fazën e Transparencës por e njëjta duhet të rregullohet me ligj ndërsa është në fazën e rritjes se Efektivitetit në prokurim publik e cila po ashtu duhet të legjitimohet. Në këtë kuptim pothuajse do të ketë ndryshime esenciale të ligjit për Prokurim Publik, të cilat do të kenë një ndikim tejet pozitiv në evitimin e dobësive të vërejtura gjatë zbatimit të ligjit aktual.

KRPP konsideron se ndryshimet ligjore me qëllim harmionizimi të mëtejm me direktivat e BE-së për prokurim publik (direktivat e reja) por edhe me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe evitimit të dobësive në sistem, duhen bërë. Për këtë qëllim, KRPP, në bashkëpunim me projektin e Komisionit Evropian, ka inicuar procesin e ndryshimeve ligjore. Ligji aktual i prokurimit publik ka specifikuar në detaje shumë aspekte ligjore të cilat kërkojnë adaptime të vazhdueshme për të mbështetur zhvillimin dinamik të prokurimit publik. Ndrydshimi i tyre përmes ndryshimeve ligjore (në Kuvend) nuk mund të përcjellë dinamikën e ndryshimeve në prokurimin publik. Andaj, kalimi nga një ligj tejet detal dhe jo-dinamik, në kuptimin e ndryshimeve, është edhe mbetet njera ndër rekomandimet kryesore nga ekspertë të fushës së prokurimit publik. Për këtë qëllim, KRPP konsideron se rishkrimi i një ligji të ri për prokurim publik, duke hequr nga ligji aktual shumë aspekte teknike dhe me karakter dinamik në ndryshime, do të ndihmonte zhvillimin efikas të sistemit të prokurimit.

Ndryshimet ligjore më tej do duhet të përcillen me ndryshimet në legjislacionin dytësor, të cilat KRPP do t'i bëjë në mbështetje të autorizimeve të veta. Këto ndryshime do të kenë një impakt thelbësor edhe ne platformën e prokurimit elektronik, andaj kosto e avancimit të kësaj platforme duhet të merret në konsideratë.

Mbështetur në arsyet e cekura shkurtimisht më lartë por edhe në shumë dimensione tjera, në të cilat ndryshimet ligjore do te kenë efekte e të cilat nuk kemi arritur t'i prezantojmë në këtë raport, KRPP rekomandon Qeverinë e Kosovës dhe Kuvendin që të përkrahin këtë reformë ligjore. KRPP dhe stafi ligjor nga Departamenti i Rregullave është shumë familjar me legjislacionin dhe specifikat e Prokurimit Publik, kërkesat dhe nevojat për ndryshime dhe kjo do ta ndihmonte shumë procesin e ndryshimeve dhe përfundimin me sukses të këtij procesi. Natyrisht që KRPP është e gatshme të jetë bartëse e këtij procesi në koordinim me akterët tjerë nga komuniteti i prokurimit publik.

Rekomandimet tjera

Me qëllim të avancimit dhe përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, KRPP-ja i propozon Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, si dhe institucioneve tjera që merren me fushën e prokurimit publik, që të ndërmarrin këta hapa:

- Të vazhdojnë dhe të rriten përpjekjet e vazhdueshme nga ana e autoriteteve kontraktuese më qëllim implementimin e plotë të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i amandamentuar;
- KRPP ka nevojë për përkrahje më të theksuar dhe në koordinim të plotë ndër institucional me qëllim të zbatimit sa më gjithëpërfshirës të prokurimit elektronik. Për këtë qëllim, KRPP ka nevojë për përkrahje të vazhdueshme në shumë aspekte e vecanërisht në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike. Ashtu sic e kemi potencuar edhe në raportet e viteve paraprake, zhvillimi i sistemit të prokurimit elektronik kërkon mirëmbajtje dhe avancim të vazhdueshëm e njëkohësisht edhe kapacitete profesionale dhe teknike si dhe kapacitete financiare të diponueshme në kohë, me qëllim që të ruhet vazhdimësia e ofrimit të këtyre shërbimeve (e-prokurimit).
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare në fushën e prokurimit publik e sidomos përmbushja e planit të veprimeve nga strategjia e të cilat ende nuk janë përmbushur;
- Vazhdimi i trajnimeve nga fusha e prokurimit publik edhe për grupe tjera të ndryshme, si p.sh. për stafin e nivelit menaxhues, për ekspertë teknik të cilët përgatisin specifikimet teknike, për auditorët e përgjithshëm si dhe ata të brendshëm etj. Në këtë drejtim, duhet bërë rritja e përkrahjes për IKAP-in dhe KRPP-në nga ana e institucioneve përkatëse.
- Fokusi më i madh në menaxhimin e kontratave, nga të gjitha palët e përfshira sidomos nga autoritetet kontraktuese dhe Zyrtarët kryesore Administrativ, por edhe për stafin teknik dhe të tjerë të përfshirë në zbatimin e kontratës;
- Të vazhdohet me monitorimin e njoftimeve PARA publikimit të njoftimit të kontratës;
- Të zvogëlohet sa është e mundur përdorimi i procedurave të negociuara, si dhe kontratave me vlera të vogla dhe minimale, duke shfrytëzuar marrëveshjet publike kornizë, si dhe prokurimet e centralizuara;
- Ngritja e vetëdijes mbi prokurimin publik në përgjithësi e për e-prokurimin në vecanti në mesin e autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomikë, institucioneve të prokurimit publik, si dhe publikut të gjerë;

Në kuadrin e sistemit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës është e nevojshme që të vazhdohet më tej të ndërmerren masa për të forcuar dhe përmirësuar:

1. **Planifikimet e prokurimit**

   Edhe më tej duhet fokusuar në përgatitjen në kuptimin kualitative të Planifikimeve (ato dorëzohen gati vetëm formalisht), specifikimi i qartë i secilit aktivitet sikur edhe specifikimi i tyre me planin e prokurimit dhe me buxhetin e vitit fiskal përkatës dhe viteve të tjera. Sidomos, autoritetet kontraktuese duhet të kenë më shumë kujdes gjatë përgatitjes së projekteve afatgjatë dhe nëse aktivitetet kanë implikime buxhetore më shumë se 1-vjecare.
   Edhe më tej mbetet sfiduese për autoritetet kontraktuese për të koordinuar aktivitetet më qëllim të harmonizimit të kërkesave dhe mundësive buxhetore sikur edhe planeve të punës me buxhetin vjetor. Ky integrim i këtyre aktiviteteve do të duhej bërë me kohë dhe para dorëzimit të Planifikimeve finale të Prokurimit. Specifikimi i qartë dhe i plotë i secilit aktivitet, i cili pritet të implementohet në periudhën buxhetore duhet të përcillet edhe me sigurimin e mjeteve buxhetore adekuate të aprovuara nga nivelet përkatëse. Specifikimi adekuat dhe në kohë i kërkesave nga njësitë kërkuese, sidomos i specifikave të kërkesës por edhe i buxhetit të nevojshëm për realizimin është mëse i nevojshëm.

2. Është tejet e nevojshme që edhe më tej të punohet te forcimi i proceseve të brendshme në AK duke filluar nga njësitë kërkuese dhe ato miratuese e deri të DP me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve sidomos në fazën e përgatitjes së Planifikimit të prokurimit. Gjatë fazës së monitorimit, KRPP ka vazhduar edhe këtë vit të konstatojë se njësitë kërkuese nuk dorëzojnë me kohë kërkesat e tyre ose i dorëzojnë pa specifikuar në nivel të duhur ato sikur edhe japin të dhëna kontradiktore për buxhetin e nevojshëm. Në këtë mënyrë duke munguar koordinimi i aktiviteteve në sektorët e AK-ve, përgatitja e Planifikimeve të Prokurimit në të shumtën e rasteve bëhet vetëm formalisht. Një praktikë e tillë duhet ndryshuar sa më shpejt.

3. **Mbetet sfiduese për AK efektiviteti** më i madh për implementimin e tërësishëm të kontratës nga inicimi i aktivitetit deri në përfundimin e kontratës. Në këtë drejtim, rekomandohen ZKA-të dhe autoritetet kontraktuese të jenë më të fokusuar në këtë fazë e cila sipas të gjitha analizave konsiderohet faza më problematike në gjithë procesin e shpenzimeve të parasë publike.

   Menaxhimi i kontratave - të dhënat e procesit të menaxhimit dhe implementimit të kontratave, pagesat dhe aspektet tjera të implementimit, edhe më tej mbesin njëra ndër sfidat kryesore të sistemit të Prokurimit Publik dhe jo vetëm sepse është larg nivelit të duhur ligjor dhe atij të performancës së mirë. Qeveria e Kosovës e sidomos Institucionet relevante të auditimit do të duhet të fokusohen më shumë në këtë fushë në mënyrë që të përmirësohet dukshëm pjesa e menaxhimit të kontratave dhe implementimi i tyre. KRPP, edhe përkundër faktit se kjo fushë e monitorimit është e lidhur vetëm me aspektet administrative të menaxhimit, do të fokusohet më tepër në monitorimin e pjesës së menaxhimit të kontratës. KRPP është e fokusuar në përmirësimin e regjistrit të të dhënave nga pjesa e menaxhimit të kontratave më qëllim të krijimit të sistemit sa më funksional në aspektet e menaxhimit të kontratave. KRPP do të monitorojë sidomos pjesën mbi respektimin e kushteve të kontratës me theks të veçantë atë të përmbushjes së dinamikës

dhe të aplikimit të masave ndëshkuese për mos zbatim të kontratës. KRPP do të monitorojë dhe raportojë me kohë mënyrën e implementimit të kontratave, dobësitë dhe të metat, të

dhëna të rëndësishme si: ndryshimet dhe variacionet në kontrata, faturimet dhe pagesat, performancën e kontraktorit etj. Pavarësisht kësaj, mbështetur në faktin se KRPP monitoron menaxhimin e kontratës vetëm <u>në aspektin administrativ</u> (plotësimi i aspekteve administrative), një mbikqyrje, auditim dhe ose hetim më detal në fushën e menaxhimit të kontratave nga institucione relevante (Auditori i brendshëm dhe ai i Përgjithshëm, Agjencia Kundër Korrupsionit etj) duhen bërë.

7. KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Nr	Komponenta e auditimit(kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	Opinioni i pamodifikuar	Raportimi për detyrimet kontigjente	A1 Kryetari i KRPP-së duhet të siguroj që me rastin e hartimit të PFV-ve, informatat për detyrimet kontigjente janë shpalosur me vlerën e drejtë dhe të plotë të tyre. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Janë marr masa e nevojshme nga Kryetari dhe ZKF-ja i KRPP-se	Kryetari dhe ZKF-ja e KRPP_së	30.12.2019
2		Mos regjistrimi I pasurive jo-kapitale dhe stoqeve në sistemin e e-pasurive	C1 Kryetari i KRPP duhet t'i sigurojë vënien në funksion të sistemit e-pasuria, me qëllim të menaxhimit efikas, regjistrimit, dhe identifikimit të gjithë pasurisë me elementet e kërkuara.	Veprimet janë në Proces- KRPP ka zyrtarët përkatës për sistem të e-pasurisë, dhe në bashkëpunim me zyrtarët e MAP është filluar përdorimi i sistemit dhe evidentimi i të gjitha aseteve të KRPP-së në sistem	Kryetari ; ZKF-ja dhe z.i Pasuris së KRPP_së	30.12.2019

8. RAPORTI FINANCIAR

Vula pranuese e Njësisë për Propozime dhe Parashtresa

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- Raporti Financiar për Vitin 2019

Kodi i Organizatës Buxhetore: 230

Informatat kontaktuese:

Zyrtari Kryesor Administrativ Z.Osman Vishaj

Zyrtari Kryesor Financiar Z.Ismet Abdullahu

Data: 27.02.2020

1) Hyrje:(Ju lutem paraqitni në formë tekstuale një përmbledhje të zhvillimeve kryesore në

Buxheti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, i ndare sipas Ligjit nr.06/L-133 për Buxhetin e Republikës se Kosovës , është 796,876 €, dhe atë sipas kategorive ekonomike ne vijim: Paga dhe mëditje 372,623€, mallra dhe shërbime 269,253 €, shpenzime komunale 5,000 € dhe kapitalet 150,000€. Ne buxhetin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik pjesën më të madhe të buxhetit e kanë pagat dhe mëditjet me 46.80%, mallrat dhe shërbimet me 33.75 %, dhe shpenzimet komunale me 0.62% dhe kapitale 18.82%.

Ndërsa Buxheti përfundimtar i KRPP-së në SIMFK në krahasim me Buxheti vjetor në Ligjin e buxhetit ka shkurtime prej 76,491€ dhe është=720,385€, i ndarë sipas kategorive ekonomike ne vijim: Pagat dhe mëditjet 296,132€, Mallrat dhe shërbimet 269,253 € , shpenzimet komunale 5,000 € dhe kapitale 150,000€.

Buxheti i shpenzuar është 600,571€: Paga dhe mëditje 296,132€,ose, 41.11% e buxhetit përfundimtar. Mallra dhe shërbime 242,316 € ose 33.61 % e buxhetit përfundimtar. Shpenzimet komunale 2,608 € ose 0.36 % e buxhetit përfundimtar dhe shpenzimet kapitale 59,515€ ose 8.19% e buxhetit përfundimtare në SIMFK.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm, del se niveli i realizimit te buxhetit te Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2019 është ne masën prej 83.37 % e buxhetit përfundimtar.

Alokimi i fondeve është bërë ne baze te planit te rrjedhës se parasë te përgatitur nga ZKF në bashkëpunim me Bordin e KRPP-së. Në këtë raport do te paraqiten ne mënyrë te hollësishme shpenzimet e realizuara nga buxheti i KRPP-së për vitin 2019, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjte te vitit 2018 . Bordi i KRPP-së. respektivisht ZKF, ka qene e kujdesshme dhe për asnjë moment, nuk kemi ardhur ne një pozite te mungesës se fondeve ne dispozicion, apo vonesës se pagesës se faturave te pranuara.

buxhetin e organizatës suaj. Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë!)

2) Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve:

(Ju lutem paraqitni shkurtimisht ndryshimet kryesore për sa i përket vlerave të parashikuara dhe atyre aktuale për secilën kategori. Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë)

KRPP-ja nuk gjeneron të hyra.

a) Të hyrat:

b) Pagat dhe mëditjet:

(Ju lutem të bashkëngjitet organo grami i organizatës suaj si aneks i këtij raporti financiar

Kategoria e Pagave dhe mëditjeve merr pjese ne buxhetin përfundimtar me 296,132€, ose me 41.11% e buxhetit përfundimtar të KRPP-së . Shuma e shpenzuar ne këtë kategori për vitin 2019 është 296,132€ shprehur ne përqindje 100% e buxhetit ne këtë kategori

dhe plotësoni tabelën shtesë lidhur me strukturën e pagesës në pikën 4 g) të këtij raporti)

c) Mallra dhe Shërbime:

Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve merr pjese ne buxhetin përfundimtar me 244,253 € ose me 44.93% e buxhetit përfundimtar të KRPP-së . Shkalla e shpenzimit te buxhetit ne ketë kategori ekonomike për vitin 2019 është 242,316 € ,shprehur ne përqindje 84.84 % e buxhetit përfundimtar ne ketë kategori .

Kategoria e shpenzimeve komunale merr pjese ne buxhetin përfundimtar me 5,000€ ose me 0.55% ne buxhetin përfundimtar të KRPP-së. Shkalla e shpenzimit te buxhetit ne ketë kategori ekonomike për vitin 2018 është 2,661 €, shprehur ne përqindje 88.07 % e buxhetit përfundimtar ne ketë kategori ekonomike.

d) Shpenzime komunale:

e) Investimet Kapitale:

f) Subvencionet dhe Transferet:

3) Përmbledhje:

(Ju lutem paraqitni shkurtimisht vërejtjet përfundimtare lidhur me buxhetin e institucionit tuaj apo pikëpamjet për zhvillimet në të ardhmen)

Në raport do te paraqiten ne mënyre te hollësishme shpenzimet e realizuara nga buxheti i KRPP-së për vitin 2019, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjte te vitit 2018.
Siç shihet nga tabela e mëposhtme në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2019 kemi shpenzime përafërsisht të njëjta me vitin 2018
Raporti i krahasimit në mes të buxhetit të planifikuar me rishikim dhe atij të shpenzuar është bërë duke e krahasuar atë me buxhetin përfundimtar.
Tek detajet e shpenzimeve për mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike në nënkategoritë ekonomike kemi disa raste kur kemi të planifikuara shpenzime por nuk kemi realizim të shpenzimeve dhe në raste të tjera kemi realizim të shpenzimeve të pa planifikuara
Krahasimet në tabelën 4.b) janë në mes buxhetit të shpenzuar dhe buxhetit përfundimtar në SIMFK; kurse në tabelën 4.c) në mes buxhetit të shpenzuar dhe buxhetit planifikuar me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-133.

_____

Nënshkrimi i Udhëheqësit të Organizatës

4) Tabelat:

4.a) Të hyrat:

(Ju lutem plotësoni tabelën me informatat e nevojshme. Mund të shtohen rreshta shtesë në tabelë)

Kodi Ekonomik	**Kategoria Ekonomike**	**Të hyrat e planifikuara/ parashikuara për vitin 2019**	**Të hyrat vet anakë të bartura nga viti 2018**	**Të hyrat realizuara në vitin 2019**
1	**2**	**3**	**4**	**5**

4.b). Shpenzimet:

(Ju lutem plotësoni tabelën me të dhënat e nevojshme.)

Kodi Ekonomik	**Kategoria Ekonomike**	**Buxheti dhe shpenzimet 2018**			**Buxheti vjetor me Ligjin e buxhetit (2019)**	**Buxheti me rishikim 2019 (nëse ka pasur ndryshime)**	**Buxheti përfundimtar 2019**	**Shpenzimet deri më 31 dhjetor 2019**	**Zotimet deri më 31 dhjetor 2019**	**Buxheti i zotuar (në %)**	**Buxheti i shpenzuar (në %)**
		Buxheti (2018)	**Shpenzimet (2018)**	**% e shpenzimit**							
1	**2**	**3**			**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**
11000	Paga dhe Mëditje	295,622	295,622		372,623		296,131.66	296,131.66			
13000	Mallra dhe Shërbime	244,253	207,025		269,253		269,253	242,316.35			
13200	Shpenzime Komunale	3,000	2,661		5,000		5,000	2,607.64			
30000	Investimet Kapitale				150,000		150,000	59,514.73			
21000	Subvencione dhe Transfere										
	Gjithsej				**796,876**		**720,384.66**	**600,570.58**			**83.33**

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2018			Buxheti 2019		
13000	**MALLRA DHE SHËRBIME Emri i kategorisë ekonomike**	**Planifikimi (2018)**	**Shpenzimet (2018)**	**% e shpenzimit**	**Planifikimi (2019)**	**Shpenzimet në (2019)**	**% e shpenzimit**
	Gjithsej Mallra dhe Shërbime	**269,252**	**207,025**	**76,88**	**269,253**	**242,316.35**	**89.96**

1310	**SHPENZIMET E UDHËTIMIT (NENTOTALI)**	**21,000**	**15,162**	**72,20**	**22,000**	**9,799.25**	**44.54**
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit						
13131	Mëditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit						
13132	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar brenda vendit						
13133	Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar brenda vendit						
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	4,000	3,645		4,000	2,964.11	
13141	Mëditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	7,000	6,696		8,000	5,114.70	
13142	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jashtë vendit	4,000	4,453		4,000	4,141.90	
13143	Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jashtë vendit	6,000	369		6,000	2,693.24	

1330	**SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT (NENTOTALI)**	**16,000**	9,979	**62,37**	**18,000**	**11,260**	**62.55**
13310	Shpenzimet për internet						
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	16,000	9,979		18,000	11,260	
13330	Shpenzimet postare						
13340	Shpenzimet e përdorimit të kabllit optik						

1340	**SHPENZIMET PER SHËRBIME (NENTOTALI)**	**26,700**	**11,043**	**41,35**	**31,353**	**22,294.97**	**70.69**
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	15,000			16,000	3,403	
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës						
13430	Shërbime te ndryshme shëndetësore						
13440	Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse		184				
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	1,500	1,717		1,500	2,082.82	
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	10,200	9,143		18,853	16,809.15	
13470	Shërbime Teknike						
13480	Shpenzimet për Anëtarësim						

1350	**BLERJE E MOBILJEVE DHE PAISJEVE (ME PAK SE 1000 EURO) (NENTOTALI)**	**9,303**	**9,561**	**102,77**	**9,000**	**4,445**	**49.38**
13501	Mobile (me pak se 1000 euro)	3,000	230				
13502	Telefona (me pak se 1000 euro)						
13503	Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	1,303	1,290		4,000		
13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)						
13505	Makina fotokopjuese (me pak se 1000 euro)						
13506	Pajisje speciale mjekësore (me pak se 1000 euro)						
13507	Pajisje te shërbimit policor (me pak se 1000 euro)						
13508	Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro)						
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	5,000	8,041		5,000	4,445	
13510	Blerja e librave dhe veprave artistike						

1360	**BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHERBIME (NENTOTALI)**	**7,000**	**3,013**	**43,04**	**4,000**	**1,611.67**	**40.27**
13610	Furnizime për zyrë	6,000	2,431		4,000	1,611.67	
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	1,000	582				
13630	Furnizime mjekësore						
13640	Furnizime pastrimi						
13650	Furnizim me veshmbathje						
13660	Akomodimi						
13670	Municion dhe armë zjarri						
13680	Tiketat siguruese(banderolat)						
13681	Bllombat						

1370	**DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE (NENTOTALI)**	**12,000**	**7,925**	**66,03**	**12,000**	**5,460.47**	**45.50**
13710	Vaj						
13720	Nafte për ngrohje qendrore						
13730	Vaj për ngrohje						
13740	Mazut						
13750	Qymyr						
13760	Dru						
13770	Derivate për gjenerator						
13780	Karburant për vetura	12,000	7,924		12,000	5,460.47	

1380	**LLOGARITE E AVANSIT (NENTOTALI)**						
13810	Avans për para te imëta (p.cash)						
13820	Avans për udhëtime zyrtare						
13821	Avans						
13830	Avans për mallra dhe shërbime						
13850	Avanc për ambasadat						

1390	**SHËRBIMET FINANCIARE (NENTOTALI)**						
13911	Provizion Bankar-Banka Qendrore						
13912	Provizion Bankar-Raiffeisen Bank						
13913	Provizion Bankar-Procredit Banke						
13915	Provizion Bankar-Banka Private e Biznesit						
13916	Provizion Bankar-Banka Ekonomike						
13917	Provizion Bankar-NLB Banka Prishtina						
13918	Provizion për Tarifa të Ndryshme						
13940	KPA-Provizioni Bankar						

1395	**SHERBIMET E REGJISTRIMIT DHE SIGURIMEVE (NENTOTALI)**	**3,450**	**1,312**	**38,02**	**2,900**	**654.56**	**22.55**
13950	Regjistrimi i automjeteve	400			400		
13951	Sigurimi i automjeteve	3,000	1,312		2,500	654.56	
13952	Taksa komunale e regjistrimit te automjeteve	50					
13953	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera						

1400	**MIRËMBAJTJA (NENTOTALI)**	**163,000**	**137,760**	**84,52**	**160,000**	**162,852.10**	**101.78**
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	12,000	2,524		10,000	2.533.10	
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave						
14021	Mirëmbajtja e ndërtesave te banimit						
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste					185.00	
14023	Mirëmbajtja e shkollave						
14024	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore						
14030	Mirëmbajtja e auto rrugëve						
14031	Mirëmbajtja e auto rrugëve regjionale						
14032	Mirëmbajtja e auto rrugëve lokale						
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	150,000	135,236		150,000	160,134	
14050	Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	1,000					

1410	**QIRAJA (NENTOTALI)**		**4,511**			**9,945.54**	
14110	Qiraja për ndërtesa						
14120	Qiraja për toke						
14130	Qiraja për paisje					123.66	
14140	Qiraja për makineri		4,511			9,821.88	
14150	Qiraja për përdorime tjera hapësinore						

1420	**SHPENZIMET E MARKETINGUT (NENTOTALI)**	**1,000**	**107**	**10,70**	**1,000**	**850.00**	**85.00**
14210	Reklamat dhe konkurset		107		1,000	850.00	
14220	Botimet e publikimeve						
14230	Shpenzimet per informim publik						

1430	**SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT (NENTOTALI)**	**9,000**	**6,618**	**73,53**	**9,000**	**8,028.09**	**89.20**
14310	Drekat zyrtare	9,000	6,618		9,000	8,028.09	

1440	**SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATAVE (NENTOTALI)**						
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave						

1700	**SERVISIMI I BORGJIT (NENTOTALI)**						
17000	Pagesa e borxhit qeveritar						

4.d).	SHPENZIMET KOMUNALE	DETAJET SIPAS KODEVE EKONOMIKE					

		Buxheti 2018			Buxheti 2019		
1320	**Shpenzimet Komunale Emri i kategorisëekonomike**	**Planifikimi (2018)**	**Shpenzimet (2018)**	**% e shpenzimit**	**Planifikimi (2019)**	**Shpenzimet (2019)**	**% e shpenzimit**
	Gjithsej Shpenzime Komunale	**5,000**	**2,661**	**53,22**	**5,000**		
1320	**SHPENZIME KOMUNALE (NENTOTALI)**	**5,000**	**2,661**	**53,22**	**5,000**	**2,607.84**	**52.15**
13210	Rryma						
13220	Uji						
13230	Mbeturinat						
13240	Ngrohjaqendrore						
13250	Shpenzimettelefonike	5,000	2,661	53,22	5,000	**2,607.84**	

4.e) INVESTIMET KAPITALE: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2018			Buxheti 2019			
3000	**INVESTIMET KAPITALE Emri i kategorisë ekonomike**	**Planifikimi (2018)**	**Shpenzimet (2018)**	**% e shpenzimit**	**Planifikimi (2019)**	**Shpenzimet (2019)**	**Zotimet deri 31.12.2019**	**% e shpenzimit**
	Gjithsej Investimet Kapitale							
3110	**NDËRTESAT (NENTOTALI)**							
31110	Ndërtesat e banimit							
31120	Ndërtesat administrative afariste							
31121	Objektet arsimore							
31122	Objektet shëndetësore							
31123	Objektet kulturore							
31124	Objektet sportive							
31125	Objektet Memoriale							
3120	**NDËRTIMI I RRUGËVE (NENTOTALI)**							
31210	Ndërtimi i auto rrugëve							
31220	Ndërtimi i rrugëve regjionale							
31230	Ndërtimi i rrugëve lokale							
31240	Trotuaret							
31250	Kanalizimi							
31260	Ujësjellësi							
31270	Mirëmbajtja investive							

3150	**FURNIZIM ME RRYMË, GJENERIMI (NENTOTALI)**							
31510	Furnizim me rrymë gjenerim dhe transmision							

3160	**PAISJE (SIST.VLERA MBI 1000 EURO) (NENTOTALI)**					**150,000**	**59514.73**	**39.67**
31600	Pajisje të Teknologjisë Informative(ne vlere mbi 1000 euro)							
31610	Pajisje të Teknologjisë Informative					150,000	**59514.73**	
31620	Mobilje							
31630	Telefona							
31640	Kompjuter							
31650	Makina Fotokopjuese							
31660	Pajisje Speciale Mjekësore							
31670	Pajisje te Shërbimeve Policore							
31680	Souftver							
31690	Pajisje Tjera							

3170	**AUTOMJETE TRANSPORTI (NENTOTALI)**							
31700	Vetura zyrtare							
31701	Kamionë							
31702	Xhip dhe kombibusë							
31703	Vetura të ndihmës së shpejtë							
31704	Veturat e shërbimit policor							
31705	Motorë							
31706	Automjete transporti tjera							

3180	**MAKINERIA (NENTOTALI)**							
31800	Makineria							

3190	**KAPITAL TJETËR (NENTOTALI)**							
31900	Kapital tjetër							
31910	Avans për investime							

3210	**TOKA (NENTOTALI)**							
32100	Toka							

3220	**PASURITË E PAPREKSHME (NENTOTALI)**							
32200	Pasuri e paprekshme							

3310	**TRANSF.KAPITALE-ENTITETE (NENTOTALI)**							
33100	Trans.kap.-entitetet publike							

4.f) SUBVENCIONET DHE TRANSFERET: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2018			**Buxheti 2019**		
21000	**Subvencione dhe Transfere Emri i kategorisë ekonomike**	**Planifikimi (2018)**	**Shpenzimet (2018)**	**% e shpenzimit**	**Planifikimi (2019)**	**Shpenzimet (2019)**	**% e shpenzimit**
	Gjithsej subvensione dhe transfere						

2100	**SUBVENCIONET**						
21110	Subvencionet për Etnitete Publike						
21120	Subvencionet për Etnitete Publike						
21200	Subvencionet për Etnitete Jopublike						

2200	**TRANSFERET**						
22100	Transfere për qeveri tjera						
22110	Unops-projekti i administratës-Agjensioni Kosovar I Pronave						
22200	Pagesat për përfitues individual						
22210	Pensionet bazë						
22220	Pensionet për persona me aftësi te kufizuar						
22230	Pensionet e ndihmës sociale						
22235	Pensionet e TMK-së						
22240	Pensionet-Kategoria I						
22250	Pensionet-Kategoria II						
22260	Pagesat për Invalidët e luftës						
22270	Pagesat për invalidët civilë						
22280	Pagesat e familjeve të të rënëve ne luftë						
22300	Pagesa-vendime gjyqësore						

4.g) Personeli dhe struktura e pagave në vitin 2019:

(Ju lutem plotësoni tabelën me të dhënat e nevojshme dhe të bashkëngjitet organogrami i institucionit tuaj me këtë raport financiar)

Niveli	**Pozitat e aprovuara me Ligjin për Buxhet 2019**	**Pozitat e plotësuara 2019**	**Buxheti i aprovuar aprovuara me Ligjin e Buxhetit për paga dhe mëditje 2019**	**Buxheti i shpenzuar për paga deri me 31 dhjetor 2019**	**Totali i pagesave shtesë 2019**	**Numri i përgjithshëm i të punësuarve që pranojnë pagesa shtesë 2019**	**a) Orari i punës (orar i plotë/gjysmë orari), dhe b) Të specifikohet lloji i pagesës shtesë, për vitin 2019**
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**
Niveli i Bordit	3	3					
Niveli i menaxhmentit të lartë	6	6					
Niveli i menaxhmentit	3	3					
Niveli profesional	26	20					
Niveli mbështetës	4	4					
Totali	42	36	372,623	296,132	15,600	6	TI

ANEX I – ORGANOGRAMI I KRPP-se